AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:**

**"Informatikë e Aplikuar" me profile "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash"**

**ofruar nga**

**Universiteti "Barleti"**


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Blerta Leka (Moçka)**

**Dr. Senada Bushati**


**Shtator / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Master i Shkencave Program në: "Informatikë e Aplikuar" me profile "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash" ofruar nga Universiteti "Barleti"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Barleti" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në:"Informatikë e Aplikuar" me profile "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhër MASR Nr.353, Datë 17.09.2021 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Me kohë të plotë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vjet/4 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohëtë plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha Shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 (shtatë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 5 PAE/ 0 PAK v.a. 2023-2024<br>3 PAE/ 1 PAK v.a. 2022-2023<br>2 PAE/ 1 PAK v.a. 2021-2022 |
| 18 | Numri i studentëve: | 13 studentë v.a. 2023-2024 |

| | | |
|---|---|---|
| | | 10 studentë v.a. 2022-2023<br>6 studentë v.a. 2021-2022 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti "Barleti" u licencua me vendim Nr. 571, date 12.08.2005 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës e Lartë Universitare, jopublike, Universiteti "Marin Barleti".

Institucioni është riorganizuar nga SHPAL në Universitet me UMASR Nr. 213 date 03.07.2020. Universiteti "Barleti" është akredituar me VBA nr. Nr. 60, datë 16.12.2021.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative (FSHAIK) është një nga katër njësitë kryesore të Universitetit "Barleti". Ky fakultet synon të arrijë standarde akademike dhe pajisjen e studenteve me dije dhe njohuri praktike të cilat do ti ndihmojnë ata të përballen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi i studimeve Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" me profile "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash" ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit të Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK). Ky program studimi ka për qëllim tu ofrojë të diplomuarve cilësi të lartë të arsimit dhe i pajis ata me një bazë të fortë, përvojë dhe njohuri për praktikat më të mira në aplikimin e njohurive kompjuterike për të përmbushur nevojat e tregut të punës. Ky program studimi ofrohet në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Studentët e këtij programi kanë mundësinë të zhvillojnë leksionet në ambjente komode, për sa i përket zhvillimit të leksionit, si dhe kanë akses në facilitete si biblioteka, laborator, etj.

Universiteti 'Barleti" (UniBa) ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme, gjë kjo e cila do të lehtësojë procesin e praktikave të studentëve. Specifikojmë se studenti në këtë program studimi, sikurse edhe në cdo program tjetër studimi te ofruar në këtë institucion, është në qendër të vëmëndjes si për departamentin dhe për institucionin që e ofron këtë program. Lektorët paraqiten të angazhuar dhe ofrojnë profesionalizëm dhe transparencë në punën e tyre.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" me profile ofruar nga Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike pranë Fakulteti të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative të Universitetit Barleti, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm.

Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentat përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumenta dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë edhe gjatë vizitës në Fakulteti të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative të zhvilluar në datat 22 dhe 23 Janar 2024 sipas një agjende të hartuar nga GVJ me asistencën e ASCAL.

Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ zhvilloi takime me: Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit, me Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, projekteve / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB), me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, stafin e Sekretarisë Mësimore si dhe studentët që ndjekin programin e studimit. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë IAL. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin objektivisht performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **Dr. Senada Bushati dhe Dr. Blerta Leka (Moçka)**. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL MSc. Arbri Ndreka,. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon raportin në ASCAL.

Universiteti "Barleti", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 09.09.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 45/22 Prot, datë 09.09.2024. Universiteti "Barleti", njofton në ASCAL, me anë të shkresës me Nr.45/23 Prot, datë 17.09.2024 " Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**<u>Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në: "Informatikë e Aplikuar" me profile: "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash" në Universiteti "Barleti"</u>**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash", ofruar nga Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK) pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative (FSHAIK), në Universitetin "Barleti" (UniBa), është hartuar duke marrë parasysh traditën e IAL-së, nevojat e tregut të punës si dhe ecurinë e proceve zhvillimore të vendit. Programi ofron cilësi të lartë të arsimit dhe nivelit të të diplomuarëve në Informatikë të Aplikuar dhe i pajis ata me një bazë të fortë, përvojë dhe njohuri në aplikimin e njohurive kompjuterike për të përmbushur nevojat e tregut të punës.<br>**Evidenca:**<br><u>A.1.1 Statuti i Universitetit Barleti</u><br><u>Web page: Diplomë Master Shkencor: Informatikë e Aplikuar, https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-informatike-e-aplikuar.html</u> |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile është hapur me Urdhër të MASR Nr. 353, Datë 17.09.2021. Ky program ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit në një nga katër Fakultetet kryesore të këtij universiteti. Misioni i Universitetit "Barleti" është të përgatisë studentë për sfidat e sotme dhe të së ardhmes, duke promovuar profesionalizmin, inovacionin dhe sipërmarrjen në një mjedis të gjallë të mësimit dhe kërkimit shkencor. Vizioni i Universitetit "Barleti" është të jetë një institucion i arsimit të lartë cilësor, i orientuar nga tregu i punës, inovativ dhe lider në fushën |

| | |
|---|---|
| | e arsimit, duke vendosur studentin në qendër dhe duke promovuar bashkëpunime rajonale dhe ndërkombëtare.<br><br>**Evidenca:**<br><br>Urdhër Nr.353, datë 2021-09-17<br><br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Programi Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, i cili evidentohet në kriterin 1 dhe 2 është hartuar dhe realizohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, Statutin e UniBa dhe të gjithë rregulloreve të tij, duke qenë sintezë e materializimit të veprimtarisë akademike të UniBa. Standardet akademike të këtij programi janë të përqendruara në kërkesën themelore të strategjisë së zhvillimit të UniBa.<br><br>Drejtimet prioritare të UniBa, mbështeten dhe përcaktohen dhe në Statutin dhe Rregulloren e universiteti, Rregulloren e FSHAIK, Rregulloren e DSHAK dhe Rregulloren e Programit të studimit në MSc në Informatikë e Aplikuar, që të gjitha së bashku bëjnë të mundur organizimin dhe realizimin e programeve të studimit, në nivelet më të larta akademike dhe të standardeve të edukimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.1.1 Statuti I Universitetit Barleti<br><br>Urdhër Nr.353, datë 2021-09-17<br><br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti<br><br>A.2.1 Rregullore FSHAIK.pdf<br><br>A.3.1 Rregullore DSHAK<br><br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile] |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës | Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, është hartuar dhe mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Arsimit dhe interesat kombëtare, Kartën e Bolonjës dhe standardet e programeve mësimore të IAL-ve dhe prirjeve globale të zhvillimit, duke pasur parasysh nevojat imediate dhe prespektivën e zhvillimit ekonomik të vendit dhe duke iu përshtatur nevojave dhe kërkesave të tregut, si në institucionet e ndryshme publike ashtu edhe ato private. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| vendas dhe atë ndërkombëtar. | **Evidenca:**<br>A.1.4 Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030 | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, në UniBa është krijuar duke marrë parasysh traditën e institucionit, nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet ekonomike të vendit. Ky program është në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të Universitetit Barleti dhe ndjek standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Fakulteti përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Informatikë e Aplikuar është Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative (FSHAIK). Ky fakultet përbëhet nga tre departamente:<br>1. Departamentin i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK);<br>2. Departamentin i Arkitekturës dhe Dizajnit (DAD);<br>3. Departamentin i Industrive Kreative (DIK);<br>Ky fakultet ofron programe studimi, të ciklit të parë Bachelor, të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional dhe Diplomë Profesionale.<br>FSHAIK në vitin akademik 2023-2024, ka gjithsej 37 pedagogë, nga të cilët 23 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe14 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: |

| **Kualifikimi i stafit** | **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative** | |
|---|---|---|
| | **PAE** | **PAK** |

| | | |
|---|---|---|
| Prof.Dr | 1 | 0 |
| Prof.Asoc | 4 | 1 |
| Dr/PhD | 7 | 3 |
| Msc | 11 | 10 |
| **Gjithsej** | **23** | **14** |

Ndërsa Departamenti i Shkencave të aplikuara dhe Kompjuterike, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024, ka këtë paraqitje:

| **Kualifikimi i stafit** | **Departamenti i Shkencave të aplikuara dhe Kompjuterike** | |
|---|---|---|
| | **PAE** | **PAK** |
| Prof.Dr | 1 | 0 |
| Prof.Asoc | 1 | 0 |
| Dr/PhD | 2 | 0 |
| Msc | 5 | 10 |
| **Gjithsej** | **9** | **10** |

**Evidenca:**

RVB - MSc. IA

Aneks, Tabelat e përgjithshme, Tabela 1 vitiakademik 2023-2024, Tabelat Përmbledhëse, fq.59-60

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe | Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, është program i ciklit të dytë të studimeve, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky program është i organizuar me njëkohëzgjate normale në 2 vite akademike dhe me një total prej 120 kreditesh (ECTS), në përputhje me parashimet e Ligjit 80/2015.<br><br>Bazuar në misionin, vizionin dhe strategjinë e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, përmbajtja e programit të studimit reflekton në nevojat e tregut të punës dhe potencialet e fushave të teknologjisë së |

| | |
|---|---|
| udhëzimeve kombëtare e evropiane. | informacionit, arkitekturës, industrisë kreative dhe dizajnit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.<br>**Evidenca:**<br>A.1.1 StatutiiUniversitetitBarleti<br>A.2.1 Rregullore FSHAIK.pdf<br>A.3.1 Rregullore DSHAK<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile]<br>Faqeëeb: https://fshaik.umb.edu.al/ |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike e praktike si dhe me aftësi për kërkim shkencor në fushat e programimit, rrjeteve kompjuterike dhe ruajtjes e përpunimit të të dhënave.<br>Fusha akademike e kërkimore e njësisë bazë DSHAK përfshin edhe fushën e përgjithshme dhe specifike të këtij programi studimi, që synon përgatijen e profesionistëve në informatikën dhe teknologjitë e informacionit.<br>**Evidenca:**<br>A.1.1 StatutiiUniversitetitBarleti<br>A.1.3 Rregullore e universitetitBarleti<br>A.2.1 Rregullore FSHAIK.pdf<br>A.3.1 Rregullore DSHAK<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile] |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | **N / A** |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e | UniBa ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar por edhe të tjerë në qendrën pranë këtij universiteti Barleti Training And Testing Center (BTTC). Kjo është qendër trajnimesh, kualifikimi, testimesh dhe certifikimesh per edukimin dhe formimin përgjatë gjithë jetës. Qendra mbulon të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | gjitha format e të mësuarit për zhvillimin profesional-praktik, formal, joformal dhe informal.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB<br>Faqe web: https://bttc.umb.edu.al/ | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ kostaton se programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, në UniBa është plotësisht në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative (FSHAIK). FSHAIK përfshin Departamentin e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK), Departamentin e Arkitekturës dhe Dizajnit (DAD), dhe Departamentin e Industrive Kreative (DIK), të cilat mbulojnë një gamë të gjerë disiplinash të lidhura me teknologjinë, dizajnin dhe industritë kreative. DSHAK, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar", përputhet në mënyrë specifike me kërkesat akademike të fushës së informatikës dhe teknologjive të informacionit, duke ofruar një bazë të fortë për zhvillimin e këtij programi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit | Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në dokumenatacionin e dorëzuar, GVJ ju konfirmua se Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative në UniBa kryen analiza mbi mësimdhënien dhe aktivitetin shkencorë të personelit akademik. UniBa mbështetet dhe nxit bashkëpunimin mes njësive dhe personelit akademik përmes organzimit të konferencave, |

| | |
|---|---|
| nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | seminareve, trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera në funksion të procesit të mësimdhënies dhe punës kërkimor-shkencore. Një mbështetje të konsiderueshme ka edhe qendra BTTC pranë UniBa.<br>**Evidenca:**<br>A.1.1 StatutiiUniversitetitBarleti<br>A.1.3 Rregullore e universitetitBarleti<br>A.2.1 Rregullore FSHAIK.pdf<br>A.3.1 Rregullore DSHAK<br>Takimet ne institucion |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Bazuar në takimet në instituacion, dokumentacionin e dorëzuar dhe informacionin në RVB, grupi i RVJ konstaton se UniBa ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit përmes marrëveshjeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit me interes reciprok. Aktualisht në shërbim të programit janë lidhur 8 marrëveshje bashkëpunimi. Pjesa më e madhe e tyre është për realizimin e praktikave profesionale.<br>**Evidenca:**<br>RVB, pdf<br>Tabelat5 Lista e marrveshjeve te bashkëpunimit përpraktikat profesionale<br>Vizita në institucion |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e | Ashtu si edhe u përmend në kriterin më sipër, GVJ konstaton se UniBa ka lidhur marrëveshje bashkepunimi për realizimin e praktikave profesionale. Për këtë program studimi këto marrëveshje janë me institucione publike rajonale dhe sipërmarrje private. Megjithatë, duke qenë se nuk ka ende studentët që kishin përfunduar praktikat profesionale, në raportin e njësisë bazë nuk ka raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.<br>**Evidenca:**<br>RVB.pdf |

| | |
|---|---|
| kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | Tabelat Lista e marrveshjeve te bashkepunimit;<br><br>Vizita në institucion |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se në mbyllje të vitit akademik, njësia bazë DSHAK trajton si pjesë të analizës vjetore edhe përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Këtu përfshihen si mobilitetet e personelit akademik dhe të studentëve, realizimi i trajnimeve, leksioneve të hapura, praktikat profesionale të studentëve dhe mundësitë e punësimit për ta. Në përfundim të praktikës, gjithashtu kryhet një raport analitik i përfitimit nga marrveshja e bashkëpunimit, *por duke qenë se studentët këtë vit akademik kanë për të përfunduar praktikën nuk ka raportim për këtë program studimi.*<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.4.1/2 Analiza dheraportivjetori DSHAK 2021-2022/2022-2023<br><br>A 3.10 Raportimi analitik për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit<br><br>RVB.pdf<br><br>Takimetnëinstitucion |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UniBa siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.*<br><br>*Në përfundim të praktikës, gjithashtu kryhet një raport analitik i përfitimit nga marrëveshja e bashkëpunimit, por duke qenë se studentët këtë vit akademik kanë për të përfunduar praktikën nuk ka raportim për këtë program studimi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br><br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimeve Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" me profile" është hapur sipas UMASR Nr.353, Datë 17.09.2021. Ai organizohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore përkatëse me lëndë e veprimtari formuese, të vlerësuara në kredite, sipas Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët mësimore janë të klasifikuara sipas kategorive A, B, C, D, E, sipas këtyre përqindjeve :<br>- Lëndë Bazë (A) : (6 kredite – 5%);<br>- Lëndë Karakterizuese (B) : (61 kredite – 50.8%);<br>- Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese (C) : (23 kredite – 19.2%);<br>- Lëndë Plotësuese (D) : (12 Kredite – 10%);<br>- Detyrime Përmbyllëse (E) : (18 kredite – 15%);<br><br>Ky program studimi është me kohëzgjatje 2 vite akademik në katër semestra, në gjuhën shqipe dhe ka gjithsej 120 kredite. Kurrikula e programit të studimit duke u bazuar në programin mësimor përmban 12 lëndë/module, praktikën profesionale dhe detyrimin përmbyllës.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master iShkencavenë "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br><br>Tabelat përmbledhëse, Tabela 10. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe RVB konstatojmë se programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" me profile synon të pajisë studentët me njohuri teorike, praktike dhe trajnimi për kërkim shkencor.<br><br>Programi i studimit është i përqendruar në zhvillimin e njohurive të përparuara dhe aftësive të studentëve në një larmi të gjerë profesionesh dhe specialitetesh të fushës së Informatikës së Aplikuar. Përmes këtij programi, studentët zhvillojnë njohuri të |

| | |
|---|---|
| të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | thelluara dhe kritike në teoritë dhe parimet akademike të fushës, duke u përgatitur për të kuptuar dhe për të aplikuar këto koncepte në mënyrë efektive në mjedisin profesional.<br><br>Përmes një qasjeje të përgjegjshme dhe analitike, studentët zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara, të cilat janë të nevojshme për të adresuar dhe zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e studimit të tyre ose në ambientet profesionale. Kjo përfshin përpjekjet për të përmirësuar të kuptuarit kritik dhe për të aplikuar njohuritë në situata reale, duke e bërë kështu studentin të përgatitur për sfidat e një tregu të punës të ndryshueshëm dhe për të kontribuar në inovacionin dhe zhvillimin e fushës së informatikës.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile<br><br>Faqe web: https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-informatike-e-aplikuar.html |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi i studimit ka një strukturë të përcaktuar të ngarkesës së kredive për të siguruar realizimin e praktikës profesionale dhe për të përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit. Plani mësimor i programit të studimit parashikon kryerjen e praktikës profesionale, e cila është e klasifikuar në kategorinë D me 12 kredite (10% e totalit tëkrediteve) dhe mbrojtjen temës së diplomës si detyrim përmbyllës, të klasifikuar në kategorinë E me 18 kredite (15% e totalit tëkrediteve). Kjo ngarkesë në kreditë është përcaktuar në përputhje më VKM nr. 14.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencavenë "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br><br>Tabela 9. Plani mësimor I ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).<br><br>Takimet në institucion |
| **Kriteri 4.**Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet | **N / A** |

| | |
|---|---|
| Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | |
| **Kriteri 5.**Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | **N / A** |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015.<br>UniBa nuk është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.<br>**Evidenca:**<br>RVB |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Nga takimet në institucion, dokumentacioni i dorëzuar dhe dokumenti i RVB programi i studimit Master i Shkencave në: "Informatikë e Aplikuar" me profile "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash" është ndër të parat specifikisht me këto profile. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi "Informatikë", në universitete të tjera, kanë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Nga takimet në institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar, UniBa është në proces të kodifikimit të programit të studimit. UniBa po përgatit kodifikimin që të dorëzohet brenda afateve të përcaktuara, në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr, 31, dt. 15.11.2022.<br><br>**Evidenca:**<br><br>[A 1.31 Shkresëdrejtuar MAS Nr 431 Prot, 27.03.2023 "Dërgohetpërgjigjapërkodifikimin e programeve"; RVB] |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i studimit MSc në "Informatikë e Aplikuar" me profile oruar nga UniBa nuk është program i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj. |
| **Konkluzione** | *GVJ konsataon se programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" me profile është krijuar dhe organizuar me përputhje të plotë me parashikimet dhe udhëzimet ligjore dhe nënligjore të Arsimit të Lartë në Shqipëri. Kjo përfshin respektimin e ligjit të arsimit të lartë, si dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë lëndët dhe veprimtaritë akademike në nivelin master. Programi ka pasur si bazë rregulloret dhe udhëzimet e brendshme të universitetit, që synojnë të sigurojnë standardet e larta akademike dhe të kualifikimit, duke përshtatur strukturën dhe përmbajtjen e programit për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e studentëve dhe tregut të punës në fushën e Informatikës të Aplikuar.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.2<br><br>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Njësia kryesore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative përbëhet nga tre departamente:<br>1. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike;<br>2. Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit;<br>3. Departamenti i Industrive Kreative;<br>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative në tre vite akademike ka përbërjen si më poshtë : |

| Kualifikimi i stafit akademik të FSHAIK | **2021-2022** | | **2022-2023** | | **2023-2024** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof. Dr | - | - | - | - | 1 | - |
| Prof. Asoc. | - | 1 | - | - | 4 | 1 |
| Dr/Phd | 9 | 3 | 9 | 4 | 7 | 3 |
| Msc. | 17 | 4 | 14 | 6 | 11 | 10 |
| **Gjithsej** | **26** | **8** | **23** | **10** | **23** | **14** |

GVJ konstaton se bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, personeli akademik i angazhuar në departamentin e DSHAK në funksion të këtij programi studimi në tre vitet e fundit akademike paraqitet si më poshtë:

| Kualifikimi i stafit | **2021-2022** | | **2022-2023** | | **2023-2024** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>akademik të DSHAK</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Prof. Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Dr/Phd</td><td>3</td><td>1</td><td>3</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Msc.</td><td>7</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>5</td><td>10</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>10</td><td>6</td><td>8</td><td>6</td><td>9</td><td>10</td></tr>
</table>
Personeli akademik i angazhuar në këtë departament e plotëson kriterin e numrit minimal që kërkohet nga Ligji nr. 80/2015.
Personeli akademik i departamentit që ofron këtë program studimi për vitin 2023-2024, janë 4 PAE me tituj dhe grada shkencore (1 Prof. Dr; 1 Prof. Asoc. dhe 2 Dr/Phd ) dhe PAK nuk ka.
Evidenca:
RVB.pdf
Tabelat përmbledhëse, Tabela 1 dhe 2 Numri I personelit akdaemik për cdo njësi bazë: PAE dhe PAK, titujt/gradat
A. 1.1 Statuti i Universiteti Barleti
A1.3 Rregullore e Universiteti Barlet.
Rregullore e Deprtamentit të Shkencave të Aplikuara dhe Kopmjuterike
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</td>
<td>
Nga dokumentacionin e dorëzuar, takimet në institucion dhe RVB konstatohet se DSHAK në këtë vit akademik ka të angazhuar 1 personel ndihmës akademik dhe dy vite më parë ka pasur 2. Personeli ndihmës akademik është i angazhuar në kujdesin dhe mbikëqyrjen e laboratorëve.
Evidencat:
Takimet në institucion
RVB.pdf
Tabelat përmbledhëse, Tabela 1 dhe 2 Numri I personelit akdaemik për cdo njësibazë: PAE dhe PAK, titujt/gradat
</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Rregullorja e Universitetit dhe Rregullorja e departamentit në UniBa parashikon edhe detyrat specifike të koordinatorit të programit të studimit. Në to përfshihen që nga organizimi i mbledhjeve të departamentit, mbikëqyrja e zhvillimit të programit të studimit, komunikimi dhe koordinimi me pedagogët sipas programeve të studimit, komunikimi i vazhdueshëm me studentët për të gjitha problematikat në lidhje mërealizimin e programit të mësimit dhe bashkëpunimi me sekretarinë mësimore. Këtë detyrë me miratim nga rektori e ka Koordinatori i Departamentit në bazë të vendimit Nr. 32 Dt 14.10.2022 "Për emërimin e koordinatorit të DSHAK"<br>**Evidenca:**<br>A 1.3 Rregullore e Univeristeti Barleti<br>A 3.1 Rregullore e Departamentit të Shekncave të Aplikuara dhe Kompjuterike<br>A 3.9. Vendim Nr. 32 Dt 14.10.2022 "Përemërimin e koordinatorit të DSHAK" |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se FSHAIK përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për numrin minimal të personelit dhe koordinatori i programit të studimit ka përcaktuar përgjegjësitë e tij në përputhje me rregullore dhe vendime administrative të institucionit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën | Bazuar në takimet në institucion, informacionin e RVB dhe dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative (FSHAIK) dhe Departamentin i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK), kanë hartuar rregullore përkatëse dhe kanë përgatitur të gjithë dokumentacionin për zhvillimin e programit të studimit |

| | |
|---|---|
| dhe përmbajtjen e programit të studimit. | me tre profile, ku përfshihen: planet mësimore, syllabuset, programet e lëndëve, personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, etj.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.2.1 Rregullore FSHAIK.pdf<br><br>A.3.1 Rregullore DSHAK.pdf |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Në planin e studimit dhe syllabuset e programit Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" me profile janë përfshirë informacionet e nevojshme për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.<br><br>Programit Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" me profile ka 14 lëndë duke përfshirë Praktikën Profesionale dhe temën e diplomës (Prova Finale). Format e vlerësimit janë: Provimi i ndërmjetëm, Pjesëmarrja dhe aktivizimi, Detyra e kursit dhe testimi me provim përfudimtar në bazë të Rregullores së Programit të Studimit. Lëndët janë ndarë sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e orëve në auditor. Programi zgjat 4 semetra.<br><br>Semestri I 38 ECTS ( 5 lëndë)<br><br>Semetri II 22 ECTS ( 3 lëndë)<br><br>Semetri III 33 ECTS ( 4 lëndë)<br><br>Semetri IV 27 ECTS (pratika profesionale dhe prova finale)<br><br><br>Praktika profesionele zhvillohet në të dy semestrat ne vitin e dytë 3 kredite të saj janë në semstrine parë dhe 9 në të dytin.<br><br>Bazuar në Planin Mësimor ngarkesa totale për 120 ECTS është 3000 orë në auditor nga ku :<br><br>• 450 Orë mësimore leksione në auditor;<br>• 313 Orë mësimore seminare, ushtrime dhe detyra kursi;<br>• 333 Orë mësimore praktikë dhe diploma;<br>• 1904 Orë punë individuale jashëauditorit.<br><br>**Evidenca:** |

| | |
|---|---|
| | A 3.3 Plani mësimor Master I Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br><br>A 3.13 Syllabuse<br><br>Tabelat përmbledhëse, Tabela 15 |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloren e brendshme për transferimin dhe regjistrimin në programe të dyta të studimeve janë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.<br><br>Transferimet në programet e ciklit të dytë Master zhvillohen në fillim të vitit akademik përmes aplikimit dhe më pas regjistrimit. Aplikimi për transferim studimesh kryhet nga një program i njëjtë ose i ngjashëm si brenda vendit ashtu edhe të huaj. Fillimisht studentët duhet të plotësojnë formularin për kërkesën e transferimit pranë Zyrës së Pranimit dhe Regjistrimeve. Dokumenta shoqëruese krahas kërkesës janë: dokument identifikimi, planin e plotë të programit të sutudimit me rezultatet e marra, vërtetimin e listës së notave me kredit, etj. Kërkesat vlerësohen nga komisioni ad hoc dhe pasi aplikanti pranon ekuivalentimin e krediteve kryen çregjistrimin nga IAL e mëparshme dhe e dorëzon atë në Zyrën e Pranimit dhe Regjistrimit në UniBa për të vazhduar me procedurën e regjistrimit.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.2Rregullore e programit të studimit Master i Shekencave ne "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br><br>A 1.22 Rregulloren e brendshme për transferimin dhe regjistrimin në programe të dyta të studimeve |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë | Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në UniBa, programi ka syllabuset për secilën lëndë. Për syllabuset respektohen formatet e miratuara për këtë qëllim në VKM nr. 41 datë 24.01.2018.<br><br>Syllabuset përmbajnë informacionin e domosdoshëm për zhvillimin e një lënde: ngarkesa mësimore, semestrin kur zhvillohet, konceptet themelore të lëndës, temat që zhvillohen, |

| | |
|---|---|
| komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | rregullat e frekuentimit dhe vlerësimit dhe literaturën bazë dhe ndihmëse.<br><br>**Evidenca:**<br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br>A 3.13 Syllabuse<br>Tabelat përmbledhëse, Tabela 14 Model syllabusi |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Nga takimet në institucion me drejtuesit, stafin dhe përfaqësuesit e zyrës e NJSBC ndryshimet në përmbajtjen e programeve e respektojnë masën 20 %, të shprehur në kredite ECTS. Këto ndryshime bëhen me miratim të Senatit. Për këtë program studimi nuk ka patur ndryshime duke qenë se ai është në vitin e tretë të funksionimit.<br><br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, GVJ konstaton se FSHAIK dhe DSHAK kanë zhvilluar rregullore dhe dokumentacion për programin e studimit Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" me profile. Ky dokumentacion përfshin planet mësimore, syllabuset, dhe informacionin për personelin akademik të angazhuar. Programi ka një strukturë të qartë për ndarjen e lëndëve në semestra dhe ngarkesën mësimore, duke përfshirë orët e lëndëve në auditorium dhe jashtë tij, si dhe ka informacione të detajuara për transferimin dhe regjistrimin e studentëve në program. Syllabuset përmbajnë të dhëna të rëndësishme për të gjitha lëndët, duke përfshirë temat, rregullat e vlerësimit dhe literaturën bazë dhe ndihmëse. Ndërkohë, ndryshimet në përmbajtjen e programeve bëhen me miratim të Senatit, duke ruajtur një masë konsistente prej 20% në kreditë ECTS. Nuk ka pasur ndryshime për këtë program.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.4<br><br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Informatikë të Aplikuar" ofrohet në tre profile "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash". GVJ nga dokumentacioni dhe vizita në institucion vlerëson se emërtimi përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat në fushat bashkëkohore në Informatikë të aplikuar. Lëndët e programit të studimit ju ofrojnë studentëve thellimin e njohurive të marra nga studimet Bachelor.<br><br>***GVJ rekomandon që në këtë program studimi përvec profileve në të cilat ka lëndë që diferencojnë ato, të shtohen edhe lëndët me zgjedhje.***<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencavenë "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Ky program studimi zhvillohet me kohë të plotë në 2 vite akademike, të shpërndara në 4 semestra, në gjuhën shqipe dhe vlerësohet gjithsej me 120 kredite. Në planin mësimor numri total i orëve mësimore është 3000 të shpërndara si vijon:<br>• 450 Orë mësimore leksione në auditor;<br>• 313 Orë mësimore seminare, ushtrime dhe detyra kursi;<br>• 333 Orë mësimore praktikë dhe diploma;<br>• 1904 Orë punë individuale jashëauditorit.<br><br>Lëndët janë të shpërndara në vite e semestra dhe vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues |

| | |
|---|---|
| | të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor në fushën e informatikës së aplikuar.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.2 Rregullore e programittëstudimit Master iShekencave ne "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master iShkencavenë "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse<br><br>Tabelatpermbledhese, Tabela 13. |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Bazuar në planin mësimor, programet e lëndëve dhe nga takimet me stafin dhe studentët, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit dhe shpërndarja e orëve mësimore dhe krediteve është e balancuar gjatë dy viteve akademike të studimit. GVJ vëren se programi i studimit, në strukturë dhe përmbajtje, është i krahasueshëm me programe të ngjashme ndërkombëtare. Konsultimi i vazhdueshëm i programeve të ngjashme brenda dhe jashtë vendit i shërben IAL-së për të ndërtuar një program studimi kompetitiv dhe me impakt në tregun e punës.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.2 Rregullore e programittëstudimit Master iShekencave ne "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master iShkencavenë "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ evidentoi se në leksione sikurse edhe në seminare tentohet vazhdimisht gërshetimi i teorisë me situata praktike. Duke patur parasysh edhe faktin që një pjesë e studentëve kur regjistrohen janë të punësuar apo punësohen gjatë periudhës së studimeve, kjo krijon mundësi edhe për diskutime dhe detyra të nivelit me praktik. Duke ju referuar vetëm orëve mësimore në auditor, plani mësimor i këtij program studimi në dy vite akademike është e shpërndarë si më poshtë:<br><br>• Teori (leksione) 450 orë mësimore në auditor; |

| | |
|---|---|
| | • Prakikë (seminare/detyra kursi/praktikë dhe diplomë) 646 orë në auditor.<br><br>Ndarja në përqindje e orëve mësimore në Teori dhe Prakikë është 41 % më 59%.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shekencave ne "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse<br><br>Tabelat permbledhes, Tabela 13 |
| **Kriteri 5.**Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Çdo lëndë ka syllabusin në gjuhën shqipe. Nga takimi me pedagogët e angazhuar në programin e studimit, GVJ vëren se stafi bëjnë përpjekje për të pasuruar literaturën në syllabuset e lëndëve në fillim të çdo viti akdemik.<br><br>Ndryshime në planin mësimor apo syllabusin e lëndëve nuk ka pasur, duke qenë se ky program është në vitet e para të veprimtarisë dhe në procesin e parë të akreditimit.<br><br>**Evidenca:**<br><br>RVB.pdf<br><br>Takimet në institucion |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Nga analiza sidomos e syllabuseve, GVJ vëren se ka përputhje midis titullit të lëndës, objektivave, literaturës dhe instrumentave të vlerësimit. GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen në këtë program studimi u ofrojnë studentëve mundësinë e përftimit të dijeve dhe afësitë që nevojiten për programet e studimit Master.<br><br>**Evidenca:**<br><br>RVB.pdf<br><br>A 3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shekencave ne "Informatikë e Aplikuar" me profile. |

| | |
|---|---|
| | A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencavenë "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Sikurse e kemi përmendur më sipër, programi është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018.<br><br>Ky program studimi i përgatit studentët përsa i përket tregut të punës, studentët mund të punësohen në sektorin privat por nuk përjashtohet edhe sektori publik.<br><br>Pas përfunimit me sukses të studimeve studentët mund të vazhdojnë edhe ciklin e tretë të studimeve.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A 3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shekencave ne "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencavenë "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit, përputhen mirë me objektivat formatuese, nivelet e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Lëndët dhe syllabuset kanë një shpërndarje të qëndrueshme të kredive dhe përputhen me standarde ndërkombëtare. Ky program përgatit efektivisht studentët për vazhdimin e studimeve akademike dhe për mundësitë e punësimit në fushat bashkëkohore të Informatikës së Aplikuar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | UniBA ka një sërë bashkëpunimesh me partnerë, të sektorit publik dhe privat. Bazuar në RVB dhe nga takimet në institucion me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, njësia bazë kryen në mënyrë periodike studime të detajuara të tregut për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. Këto studime gjithashtu ndihmojnë në hapjen dhe organizmin e programeve të reja në përputhje me punësimin dhe kërkesat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Për sa i përket programit në fjalë është një program i ri dhe akoma nuk është marrë një feedback nga tregu i punës.<br>**Evidenca:**<br>RVB.pdf<br>Takimet në institucion<br>A 3.6 Studimi i tregut të punës<br>A 3.7 Marreveshjebashkepunimi<br>Tabelatpermbledhese, Tabela 5 |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe nga takimi me studentët u informuam se ato kishin një sërë instrumentash në dispozicion, formalë dhe informalë, për të dhënë mendimin e tyre si mbledhjet që kryhen në departament, përfaqësimi i tyre në senatin Akademik dhe Këshillin Studentor.<br>**Evidenca:**<br>Takimet me studentët dhe zyrën e karrierës<br>A 1. 1 Statuti i Universiteti Barleti |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete | Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se DSHAK mban kontakte të vazhduara me aktorët e ndryshëm në fushën e zhvillimit tësoftuar-ëve, rrjeteve komjuterike dhe teknologjike bashkëkohore. Qëndrat pranë UniBa janë gjithashtu një mbështetje për trendet më të fundit të teknologjisë dhe ndihmojnë në njohjen e zhvillimeve ndërkombëtare dhe aplikimin e përditësimeve në modulet e studimit.<br>**Evidenca:** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Takimet në institucion<br>A 3.6 Studimi i tregut të punës | | | |
| **Konkluzione** | *UniBA ka zhvilluar një rrjet të gjerë bashkëpunimi me partnerë nga sektori publik dhe privat. Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe takimet me stafin akademik, institucioni zbaton studime të detajuara të tregut për të përmirësuar përmbajtjen dhe për të përshtatur programet e studimit me nevojat aktuale të tregut të punës. Këto përpjekje gjithashtu ndihmojnë në identifikimin dhe organizimin e programeve të reja për të përshtatur me kërkesat në nivele vendore dhe ndërkombëtare. Ndryshime në progamin e studimit nuk ka pasur.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Në rregulloren dhe strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile janë të specifikuara objektivat dhe prioritetet kryesore të programit të studimit. Ato janë në përputhje me objektivat kryesore të UniBa që janë paraqitur në Statut dhe në Strategjinë e zhvillimit Institucional.<br>**Evidenca:**<br>A 1.1 Statuti i Universiteti Barleti.pdf<br>A.1.4 Strategjia e Zhvillimit institucional 2020-2030.pdf<br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile<br>A.3.5 Strategjia DSHAK 2022-2025 |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, | Njësia bazë e programit të studimit DSHAK ashtu si edhe është specifikuar në statutin e UniBa e mbështet personelin akademik |

| | |
|---|---|
| bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | në procesin mësimdhënës dhe në aktivitetet kërkimore dhe shkencore duke respektuar lirinë akdemike.<br>**Evidenca:**<br>Takimet ne institucion me personeli nakademik<br>A 1.1 Statuti i Universiteti Barleti.pdf<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>A.2.1 Rregullore e FSHAIK<br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Nga vizita në institucion, dokumentacionet dhe RVB vlerësohet se DSHAK nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore gjatë detyrave të kursit dhe përgatitjes së temës së diplomës. Qendra dhe laboratorët që UniBa ka, janë gjithmonë në dispozicion të studentëve për të aplikuar idetë e tyre. Studentë që janë në këtë program studimi janë të angazhuar nëmbikëqyrjen e laboratorëve dhe në mbështetjen e studentëve të programeve të ciklit të parë.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB.pdf<br>A.3.8.1 Raporti Vjetor i punës kërkimore shkencore DSHAK 2021-2022<br>A.3.8.2 RaportiVjetor i punës kërkimore shkencore DSHAK 2022-2023 |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | UniBa i mbështet studentët dhe njësinë bazë në realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore. UniBa gjithashtu administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Nga takimet në institucion UniBa e mbështet finfaciarisht stafin në pjesëmarrjen pa pagesë në konferenca dhe botime shkencore, si dhe një angazhimin në projekte ndërdisiplinore në Qëndrat kërkimore tëUniBa.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | RVB.pdf<br>A.3.8.1 Raporti Vjetor i punës kërkimore shkencore DSHAK 2021-2022<br>A.3.8.2 Raporti Vjetor i punës kërkimore shkencore DSHAK 2022-2023 | | | |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile, në UniBa siguron orientim të qartë në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Strukturat institucionale si Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike (DSHAK), Qendrat Kërkimore të Universitetit, dhe Zyrja e Karrierës dhe Punësimit, janë njësitë kryesore që ofrojnë mbështetje të rëndësishme për studentët dhe stafin akademik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Nga takimet me stafin akademik DSHAK mbështet dhe nxit veprimtaritë mësimore dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor dhe stafit të tij akademike. Aktivitet Erasmus+, konferencat dhe institutet dhe qendrat kërkimore në UniBa janë në mbështetje të këtyre përmirësimeve.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB.pdf<br>A.3.8.1 Raporti Vjetor i punës kërkimore shkencore DSHAK 2021-2022<br>A.3.8.2 Raporti Vjetori punës kërkimore shkencore DSHAK 2022-2023 |

| | |
|---|---|
| | A 1.35 Të dhëna mbi marrëveshjet e bashkepunimit (MoU), mobilietet e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus+ |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Nga takimet në institucion GVJ konstatoi se DSHAK dhe UniBa angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor. Këto pasqyrohen edhe në konkurse dhe aktivitete ndërkombëtare ku institucioni ka marr pjesësi Erasmus për staf dhe student, konkurset ndërkombëtare në fushën e ICT, etj.<br><br>**Evidecat:**<br><br>Takimet në institucion<br><br>RVB.pdf<br><br>A.3.8.1 Raporti Vjetori punës kërkimore shkencore DSHAK 2021-2022<br><br>A.3.8.2 Raporti Vjetori punës kërkimore shkencore DSHAK 2022-2023 |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | GVJ nga takimet në institucion dhe nga dokumentacioni i vendousr në dispozicion konstaton se DSHAK organizon leksione të hapura me ekspertë të fushës duke ndihmuar personelin dhe studentët në përditësimim e njohurive në zhvillimet më të fundit teknologjike. Gjithashtu institucioni zhvillon konferenca dhe workshope.<br><br>Departamenti i Shkencave Aplikative dhe Kompjuterike ka përcaktuar kursin e vet kërkimor në krijimin e metodave dhe procedurave të reja aplikative që kanë mbështetje shkencore dhe teorike dhe mbështetet në pistat krijuese të anëtarëve të departamentit. Fushat e kërkimit shkencor të anëtarëve tanë të stafit përfshijnë së paku këto fusha: algoritmet, rrjetat kompjuterike, sigurinë kibernetike, analizën e të dhënave dhe OpenScience. Anëtarët e stafit të departamentit tonë marrin pjesë në iniciativa e projekte të rëndësishme të Shqipërisë dhe rajonit siç janë: konferenca BalkanComm, programi ICTinSES dhe akcionet COST.<br><br>**Evidencat:**<br><br>A.1.36 Lista e konferencave, trajnimeve dhe workshopeve |

| | |
|---|---|
| | Faqe web: https://fshaik.umb.edu.al/kerkimi-shkencor.html |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | Programi i studimit ofron përshtatshmëri me nevojat e tregut të punës, duke ofruar një kombinim të thellë të njohurive teorike dhe praktike në fushën e informatikës së aplikuar. Me një theks të veçantë në inxhinierinë softuerike, rrjetet dhe sigurinë kibernetike, studentët janë të pajisur me një arsenal të shkathtësive që u nevojiten për të konkuruar në tregun e punës, si në nivelin kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Përmes këtij programi, ata mund të gjejnë dhe shfrytëzojnë informacionin në mënyrë efikase, duke u bërë kështu pjesë e fuqisë punëtore e përgatitur për të përballuar sfidat e teknologjisë së informacionit në një kontekst global.<br>**Evidecat:**<br>Faqe web:https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-informatike-e-aplikuar.html |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me profile nuk është profesion i rregulluar në Shqipëri.<br>**Evidenca:**<br>RVB.pdf |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me profile nuk është profesion i rregulluar në Shqipëri.<br>**Evidenca:**<br>RVB.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile garanton njohuri të* |

| | |
|---|---|
| | *thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Përvoja e aktiviteteve Erasmus+, konferencave dhe qendrave kërkimore në Universitetin Barleti shërbejnë si dëshmi për mbështetjen e përmirësimit të orientimit të studentëve në studime dhe kërkime shkencore.* |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Nga dokumentacioni, shqyrtimi i informacionit të RVB dhe takimet në institucion rezultoi se procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies harmonizon format tradicionale si leksionet, seminaret, apo detyrat e kursit, me projekte dhe praktikat profesionale duke mbajtur parasysh ngarkesen në orët mësimore të punës individuale dhe orëve në auditor. Në syllabuset e lëndëve janë përfshirë informacione në lidhje me numrin e orëve të leksioneve, seminareve dhe detyrave e projekteve të kursit. Në to është e përcaktuar edhe mënyra e vlerësimit të kursit.<br>**Evidencat:**<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>A.2.1 Rregullore e FSHAIK<br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile |

| | |
|---|---|
| | A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Nga takimet në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik përpiqet që të përzgjedhë format më efektive të mësimdhënies duke patur parasysh orën e mësimit, karakteristikat e lëndës, numrin dhe nivelin e mësim nxënies së studenteve, literaturën në dispozicion, gjuhës anglisht të mësimit, si edhe kombinimin e aspektit teorik me atë praktik.<br><br>**Evidencat:**<br><br>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët,<br><br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10 |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | UniBa mbështet personelin akademik në procesin e përmirësimit të mësimdhënies duke mundësuar përdorimin e mjeteve didaktike më të përshtatshme për tematikën e trajtuar përfshirë këtu edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe trajnimet për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Auditorët janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet, ndonëse vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm.<br><br>UniBa gjithashtu e mbështet personelin akademik me trajnime dhe leksione të hapura, pjesëmarrjen në konferenca dhe ofrimin e moduleve në ndihmë për organizmin e mësimit.<br><br>**Evidencat:**<br><br>Vizita në institucion: Vëzhgimi i mjediseve auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.<br><br>A 1.35 Të dhëna mbimarrëveshjet e bashkepunimit (MoU), mobilietet e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus+<br><br>A3.18. Të dhëna mobilitet Erasmus+ -DSHAK |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në | Në takimin e GVJ me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit u theksua se institucioni i kushton rëndësi përzgjedhjes së stafit |

| | |
|---|---|
| mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studenti mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br><br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | akademik duke angazhuar staf me tituj e grada, të arsimuar në universitete të huaja për të qënë sa më kompetentë dhe në trajtimin e lëndëve në këtë program studimi. GVJ vlerëson që stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojën e duhur profesionale dhe akademike në shpjegimin dhe në transmetimin e njohurive dhe koncepteve të cilat ofrohen nga ky program. Kualifikimet dhe eksperienca e përfituar brenda dhe jashtë institucionit, si dhe aplikimet në projekte kombëtare, ndihmojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e metodave didaktike të përdorura.<br><br>**Evidencat:**<br><br>Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët,<br><br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile<br><br>A.3.14 CV stafi i angazhuar ne mësimdhënie në programin e studimit MSH në "Informatikë e aplikuar" me profile |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | FSHAIK në UniBa ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studentëve në këtë proces. Për këtë qëllim shërbejnë takimet e dretjpërdrejta me ta, takimet me përfaqësuesit e tyre në forumet Universitare dhe pyetësori i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatin e tyre, si dhe fokusgrupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe përgjegjësit të njësisë bazë, dekanit dhe zv/rektorit të mësimit. Këto të dhëna analizohen me kujdes për të gjitha elementet që kanë ndikim në mësimdhënie.<br>**Evidencat:**<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>A.1.11 Formular vlerësimi i studentëve për lëndën<br>A.2.1 Rregullore e FSHAIK<br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile<br>A.3.24.1 Raporti pyetësorëve të studentëve v.a. 2022-2023- Sem. I<br>A.3.24.2 Raporti pyetësorëve të studentëve v.a. 2022-2023- Sem. II |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të | UniBa ka ngritur struktura në nivel institucional dhe fakulteti për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Në rregulloren e UniBa cilësohet ngritja e strukturave të pavarur në nivel universitar, si:<br>• Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë (KSSC) d<br>• Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC).<br>Këto dy njësi promovojnë dhe monitorojnë cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim edhe me njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit.<br>Koordinator i DSHAK pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative është bashkëpuntori kryesor mes këtyre strukturave të pavaruar dhe njësisë bazë në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. KSSC përbëhet nga |

| | |
|---|---|
| mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | pesë anëtarë të propozuar nga Rektori, ku njeri prej tyre është student. KSSC mbështet dhe këshillon organet drejtuese tëUniBA, si dhe lehtëson komunikimin mes strukutave të ndryshme të institucionit lidhur me politikat dhe procedurave për sigurimin e cilësisë në përputhje me rregulloret në fuqi. NJZHKC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, orienton zhvillimin e kurrikulave dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme mbështetur në kuadrin ligjor.<br>**Evidencat:**<br>A 1.1 Statuti i Universiteti Barleti.pdf<br>A.1.4 Strategjia e Zhvillimit institucional 2020-2030.pdf<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>A.1.9 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë<br>A.2.1 Rregullore e FSHAIK<br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile<br>A.1.28 Plani i punësi NjZhKC<br>A.3.25 Raport nga NjZhKC mbi monitorimin e mësimdhënies në distance ndërmjet teknikave digjitale dhe internetit. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se procesi i mësimdhënies në institucionin është në harmonizimin e formatit tradicional me praktikat profesionale dhe përdorimin e mjeteve didaktike të përshtatshme. Përpjekjet e strukturave institucionale dhe fakultetit për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies tregojnë një angazhim të vazhdueshëm për cilësi më të lartë në arsim.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2** |
|---|
| **Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** |

<table>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</td><td>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në UniBA, se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me focus parësor aftësimin e tyre. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e Programit të studimit.<br><br>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së UniBa realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegiumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; detyrave të kursit që lidhen me problematikën e disiplinës; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës. Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet me karakter professional dhe programet e studimit të ofruar në UniBa dhe realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit nga nota 1 derinë 10, ku nota 5 rezulton si note kaluese. Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kritereve të përcaktuara ku:<br><br>• Pjesëmarrja dhe aktivizimi - 10%,<br>• Detyra kursi- 20%,<br>• Provimi i ndërmjetëm - 20%,<br>• Provimi përfundimtar - 50%.<br><br>Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve, që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.<br><br><u>Evidencat:</u><br><br><u>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf</u><br><br><u>A.2.1 Rregullore e FSHAIK</u><br><br><u>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master I Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile</u><br><br><u>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10</u></td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Gjatë takimeve në institucion me stafin akademik dhe studentët u komunikua se në fillim të lëndës në çdo semester, pedagogu i lëndës i njeh studentët me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar emërimi dhe kreditet e lëndës, pedagogu i lëndës, vit/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin e studentit, ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë tij, literatura e detyruar, si edhe mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.<br><br>*Takimet në institucion me stafin dhe studentët* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Bazuar në rregulloret e UniBa-së, Rregulloren e Fakultetit, rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teorik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final, per të testuar sa më real i shtojnë njohuritë dhe kompetencat e studentëve.<br><br>**Evidencat:**<br><br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br><br>A.2.1 Rregullore e FSHAIK<br><br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse |
| **Konkluzione** | *Gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe vizitave në UniBa, GVJ konstatoi përdorimin e metodave të efektshme për vlerësimin e dijeve të studentëve, duke u përqendruar kryesisht në aftësimin e tyre. Metodat e përdorura për vlerësim përfshijnë teste, detyra kursi dhe provime përfundimtare, të përcaktuara sipas rregullores së Fakultetit dhe Programit të Studimit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.3<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët GVJ konstaton se UniBA aplikon një metodologji të qëndrueshme dhe të përshtatshme për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve gjatë gjithë vitit akademik. Ky proces është i integruar në syllabuset e lëndëve dhe moduleve, siç është parashikuar nga titullarët e tyre. Të gjitha lëndët kanë vlerësim të vazhduar dhe provim final.<br>**Evidencat:**<br>Takimet në institucion<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>A.2.1 Rregullore e FSHAIK<br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile<br>A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | GVJ nga takimet në institucion konstatoi se UniBa ka sistemin e portalit studentor ku është i përfshir edhe sistemi i vlerësimit elektronike të specializuar që ndihmon në shmangien e formave të ndryshme të abuzimit dhe rrit transparencën në procesin e vlerësimit. Sisteme të tjera elektronike janë Google Classroom, Zoom ,etj. që po vazhdojnë ende të përdoren që nga koha e pandemisë. Këto sisteme janë krahas mënyrave standarte në kontrollit në letër me shkrim dhe formave të pyetjes me gojë.<br>**Evidencat:**<br>RVB.pdf<br>Takimet në institucion me studentët dhe stafin akademik.<br>A.1.34 Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa; |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje të plotë me të dhënat dhe kërkesat e përcaktuara në syllabus, duke respektuar gjithashtu bazën ligjore aktuale në fuqi. Informacionin e ndarjes së kontrollit të lëndës studentët e marrin që në fillim të çdo lënde. Përpara provimit përfundimtar i cili është 50 pikë ose 50% e vlerësimit ju bëhet i ditur edhe vlerësimi i tyre i vazhdueshëm. Provimi përfundimtar zhvillohet me shkrim dhe i sekretuar nga sekretaria mësimore e UniBa.<br>**Evidencat:**<br>Takimet në institucion<br>A 3.13 Syllabuse, Tabela 15 |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Nga dokumenti i RVB vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente nëse ato janë të nevojshme dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Një përmbledhje dhe seancë sqaruese me studentët kryhet në orët e fundit të mësimit përpara provimit përfundimtar. Studentit gjithashtu i bëhet i ditur vlerësimi i vazhduar përpara provimit final.<br>**Evidencat:**<br>Takimet në institucion<br>RVB.pdf |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Në rregulloren e programit të studimit, atë të fakutletit dhe rregulloren e UniBa kopjimi, plagjiatura apo paraqitja si punë e vetë e punës së një tjetri, si dhe blerja, shitja ose vjedhja e materialeve që përbëjnë pyetja apo teza provimi; institucioni merr masa disiplinore si: vërejtje me shkrim, pezullim deri në një vit nga UniBa, deri në përjashtim. Në takimin me stafin akademik për këtë kontroll të detyrave ose punimeve të diplomave disa nga profesorët përdorinin programe të posaçme.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>A.2.1 Rregullore e FSHAIK |

| | |
|---|---|
| | A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rezultatet e provimit nga takimet me studentët dhe stafin akademik bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve të afateve kohore duke ju lënë një mundësi studentëve për rishikim të tyre në mosdakortsim. Vlerësimet përfundimtare dokumentohen në procesverbalin e vlerësimit dhe në Regjistrin e Rezultateve Akedemike. Këto rezultate dorëzohen në sekretari nga pedagogu i lëndës brenda 5 ditëve nga data e provimit.<br>**Evidencat:**<br>Takimet në institucion<br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Në rregulloren e UniBa por edhe nga takimet me studentët GVJ konstaton se studentët kanë të drejtë ankimimi lidhur me zhvillimin dhe vlerësimin e provimit duke i bërë një kërkesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit. Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me komisionin e provimit bëjnë verifikimet dhe rishikimet sipas situatave.<br>**Evidenacat:**<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>Takimet në institucion |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Ankimimet shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Nëse pas shqyrtimit nga komisioni i vlerësimit, studenti nuk bie dakort me vlerësimin, ai i bën një kërkesë me shkrim tek përgjegjësi i Departamentit. Përgjegjësi i Departamentit vë në dijeni Dekanin dhe ai brenda 48 orëve krijon një komision të posaçëm ad-hoc për verifikimet e pretendimeve të studentit. Nuk ka pasur procedura të tilla dhe nuk ka dokumentacion për kryerje të tyre.<br>**Evidenacat:**<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>Takimet në institucion |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Nga analiza e dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se, UniBa zbaton një metodologji të qëndrueshme për vlerësimin e njohurive dhe aftësive të studentëve në përputhje me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara. Sistemet e vlerësimit elektronik dhe transparenca në procesin e vlerësimit kontribuojnë në sigurimin e një vlerësimi të drejtë dhe objektiv për të gjithë studentët. Studentët kanë të drejtë ankimimi lidhur me zhvillimin dhe vlerësimin e provimit duke i bërë një kërkesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4** | |
|---|---|
| **Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Bazuar në informacionin e dokumentacionit të dorëzuar dhe RVB, programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, në trajtimin e tij është i strukturuar në mënyrë që të përmbush qëllimet për thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve në fushën e informatikës aplikuar. Studentët marrin njohuri të thelluar në zhvillimin dhe menaxhimin e softuerëve, programimin Web e Mobile, bazat e të dhënave, siguria kibernetike dhe IoT, etj.<br>**Evidenca:**<br>RVB.pdf<br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br>A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe | Programi i studimit për Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile është i strukturuar në mënyrë të përshtatshme për të garantuar zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). Përfshirja e lëndëve si: "Metodat e kërkimit shkencor" dhe |

| | |
|---|---|
| ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | "Projekt në grup" i ndihmojnë studentët në zhvillimin e aftësive të veçanta si komunikimi dhe analiza kritike.<br><br>Metodat e vlerësimit që inkurajojnë angazhimin e studentëve në diskutime, seminare dhe kolegiume, duke përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit dhe ndërveprimit.<br><br>**Evidenca:**<br><br>Vizita në institucion<br><br>RVB.pdf<br><br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br><br>A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Programet e studimit dhe syllabuset për programin e studimit Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile janë avancim dhe thellim i njohurive të studentëve nga programet e ciklit të parë. Në përfundim të lëndëve stafi akademik përqëndrohet në çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse, si punët e laboratorit dhe detyrat e kursit përmes të cilave testohen njohuritë e përfituara nga studneti për lëndë. Tema e fundit është një përsëritje përpara sezonit të provimeve për temat e zhvilluara.<br><br>**Evidenca:**<br><br>Takimet në institucion<br><br>RVB.pdf<br><br>A.3.13 Syllabuse.pdf |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e | Në takimin më studentët u theksua se ata ndiheshin mjaft të mbështetur nga personeli akademik në diskutimin, shprehjen e ideve të reja e inovative. Në suport për mbështetjen e këtyre ideve dhe realizimin e tyre e kishin dhe nga qendrat dhe klubet që UniBa ka. Në takimin më personelin e këtyre strukturave gjithashtu u nënvizua suporti që ato kanë për krijimin e një klime të përshtatshme të përparuara kërkimore e shkencore për studentët dhe stafin akademik. GVJ konstaton në planin mësimor të studimit dhe syllabuset janë hartuar për të nxitur bashkëpunimin dhe punën në grup të studentëve përmes |

| | |
|---|---|
| problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | detyrave të kursit, prezantimeve të ndryshme dhe analizës së rasteve studimore.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>REV.pdf<br>A 3.3 Plani mësimor Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile, Tabela 9 dhe 10<br>A 3.13 Syllabuse |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Nga takimet në institucion më personelin akademik dhe nga RVB, DSHAK organizon herë pas here leksione të hapura për zhvillimet e fundit teknologjike. Këtë aktivitet janë të pasqyruar dhe në faqen e web të UniBa. Leksionet janë jashtë strukturës së programit testimit dhe ato parashikohen nga departamenti për vitin akademik.<br>**Evidenca:**<br>RVB.pdf<br>Takimet në institucion<br>Faqe web |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Qendrat dhe institutet kërkimore në UniBa ju japin mundësi studentëve në përfshirje dhe suporte financiare në projekte të ndryshme. Kjo kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes klubeve studentorë tëUniBa.<br>**Evidenca:**<br>A 3.4.1/2 Analiza dhe raporti vjetor i DSHAK 2021-2022/2022-2023<br>RVB.pdf<br>Takimet në institucion |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit për Master në "Informatikë e Aplikuar" me profile, në UniBa siguron një ambient të përshtatshëm për rritjen e aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët. Përmes përdorimit të metodave të përshtatshme mësimore, përfshirjes së lëndëve që inkurajojnë analizën kritike dhe organizimit të leksioneve të hapura për zhvillimet teknologjike, programi i studimit synon të forcojë kompetencat profesionale dhe* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *shkencore të studentëve në fushën e informatikës së aplikuar. Përveç kësaj, mbështetja e strukturave kërkimore dhe klubet studentore, si dhe përfshirja në projekte të ndryshme, kontribuojnë në avancimin e aftësive dhe njohurive të studentëve në një mjedis stimulues dhe inovativ.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | UniBa harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. Nga takimet në institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar studentëve diplomantë përpara provës finale të dipomës së studimit ju vihet në dispozicion paketa e provës finale, në të cilën janë proceduar dhe udhëzimet për përgatitjen dhe mbrojtjen e saj.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB.pdf<br>A.3.11 UniBa Paketa e provës finale |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | DSHAK dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse dhe përgatitjes së punimit të diplomës. Komisioni i mbrojtjes së diplomës oranizohet me jo më pak se tre anëtar, të cilët janë propozuar nga përgjegjësi i DSHAK dhe miratohen nga Dekani i fakultetit.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB.pdf<br>A.3.11 UniBa Paketa e provës finale |

| | |
|---|---|
| | Faqe web |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Në bazë të Rregullores së programit të studimit, studimet përmbyllen me Provën Finale, e cila është punim diplome. Një Paket e provës finale ju vihet në dispozicion studentëve për përgatitjen e punimit të diplomës.<br>**Evidenca :**<br>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me pofile, neni 16<br>A.3.11 UniBa Paketa e provës finale |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Nga takimet me stafin akademik, studentët dhe dokumentacionet e dorëzuara u konstatua se udhëheqësit e diplomës janë në mbështetje dhe konsulencë të vazhduar për studentët të cilët po përgatisin punimin e tyre të diplomës. Ata i orientojnë dhe ndihmojnë studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës, burimin e informacionit, rekomandimin e shkrimit të dokumentacionit, etj.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB.pdf<br>A.3.11 UniBa Paketa e provës finale |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Laboratorët dhe ambjentet e tjera të UniBa mund të përdoren nga studentët në punën e tyre të pavarur për përgatitjen e punimit. Takimet nga udhëheqësi i temës kryhen në mënyrë të vazhdueshme për të parë ecurinë dhe për të rekomanduar literatura dhe burime të tjera informacioni.<br>**Evidenca:**<br>Takimet në institucion<br>RVB.pdf<br>A.3.11 UniBa Paketa e provës finale |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Komisioni përkatës i diplomës në përfundim të mbrojtjes së temës së diplomës bënë vlerësimin e studentëve me notat nga 4-10 dhe me pikë në përqindje, sipas rregullores sëUniBa.<br>**Evidenca:**<br>Takiment në institucion<br>RVB<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në bazë të RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar GVJ kostaton se në përfundim të studimeve në programin Master i Shekncave në "Informatikë e aplikuar" me profile, pasi studenti ka përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe ato financiare pajiset me diplomën përkatëse, listën e notave dhe suplementin e miratuar. Me kërkesë të studentit vihet në dispozicion edhe programi mësimor për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimi.<br>**Evidenca:**<br>Takiment në institucion<br>RVB<br>A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.pdf<br>A.3.16 Format diplome Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me profile<br>A.3.17 Format suplementi Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar" me profile |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Nga vizita në sekretarinë mësimore dhe dokumentacioni i dorëzuar, GVJ kostaton se të dhënat e studentëve ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Këto të dhëna ruhen në dosjet personale të studentëve dhe pas diplomimit në arkivën përkatëse tëUniBa.<br>**Evidenca:**<br>Takiment në institucion<br>RVB |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UniBa ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Përmes paketës së provës finale dhe mbështetjes së DSHAK dhe personelit akademik, studentët janë të pajisur me udhëzime dhe materiale të nevojshme për përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës. Përveç kësaj, udhëheqësit e temës ofrojnë konsulencë të vazhdueshme dhe orientim për studentët gjatë këtij procesi, duke siguruar një mbështetje të vazhdueshme në rrugën drejt suksesit të tyre akademik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Ky kriter nuk zbatohet. |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | Ky kriter nuk zbatohet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Ky kriter nuk zbatohet. | | | |
| **Konkluzione** | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br><br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Institucion, GVJ konstaton se departamenti përgjegjës për këtë program studimi mban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie, ku përfshihet personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet çdo vit, lëndët që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për çdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale. |

<table>
<tr><td>programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</td><td>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është si më poshtë :<br><br><table><tr><td rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</td><td colspan="2">2021-2022</td><td colspan="2">2022-2023</td><td colspan="2">2023-2024</td></tr><tr><td>PAE</td><td>PAK</td><td>PAE</td><td>PAK</td><td>PAE</td><td>PAK</td></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>2</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>2</td><td>1</td><td>3</td><td>1</td><td>5</td><td>0</td></tr></table><br>Evidenca:<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, fq.59-60)<br>A.3.14 CV stafi akademik MSc. IA - v. a. 2023 - 2024.pdf</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</td><td>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në universitetin Barleti, GVJ konstaton se universiteti ka një rregullore në të cilën përcaktohet procedurat dhe funksionet e njësive drejtuese, të cilat ndikojnë në ndarjen e ngarkesës.<br><br>Bazuar në tabelat 12.3 [Aneks, Tabelat Përmbledhëse, fq.70], u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë vijon:<br><br><table><tr><td>Viti</td><td>Total orësh</td><td>PAE</td><td>PAK</td><td>PAE/PAK (%)</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>514</td><td>386</td><td>128</td><td>75.1% / 24.9 %</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>762</td><td>566</td><td>196</td><td>74.3% / 25.7%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>762</td><td>762</td><td>-</td><td>100 %</td></tr></table></td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | Nga sa më sipër, tabela rezulton që për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.<br><br>***Do të ishte e përshtatshme shtimi i stafit akademik PAK për këtë program studimi. Ngarkesa totale e personelit akademik efektiv të programit të studimit është e lartë.***<br><br>**Evidenca:**<br><br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Aneks, Tabelat Përmbledhëse, fq.69-70).<br><br>A.1.1 Statuti i Universitetit Barleti.pdf<br><br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf<br><br>A.2.1 Rregullore FSHAIK.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Institucion, GVJ konstaton se Universiteti Barleti ka kontrata pune me secilin punonjës të stafit akademik PAE dhe PAK. Çdo fillim viti burimet njerëzore në bashkëpunim me fakultetin dhe departamentin përgjegjës për programim Master i Shkencave "Informatike e aplikuar" me profile, përditësojnë listën e personelit akademik. Në zyrën e burimeve njerëzore gjenden dosjet e personelit, në të cilat përfshihen kontratat e punës, raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, cv, diploma, kualifikime etj. Kohëzgjatja e kontratës së punës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme ishin me kohë zgjatje të ndryshme, sipas specifikave dhe kategorive të ligjit në fuqi, përkatësisht me kohëzgjatje të pa përcaktuar, njëvjecare,semestrale etj. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, vërehet në evidencat e ofruara nga IAL-ja.<br><br>**Evidenca**:<br><br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse)<br><br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf<br><br>A.2.1 Rregullore FSHAIK.pdf |

| | |
|---|---|
| | A.3.1 Rregullore DSHAK.pdf<br><br>A.1.8 Formati i Dosjes personale të stafit.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Bazuar ne RVB-në e paraqitur nga IAL dhe në varësi të nevojave të departamentit, FSHAIK i paraqet zyrës së menaxhimit të burimeve njerëzore (ZMBNJ) kërkesën për fillimin e procesit të rekrutimit. ZMBNJ shpall vëndin vakant në faqen zyrtare të universitetit, https://www.umb.edu.al/zyra-e-menaxhimit-te-burimeve-njerezore.html. Aplikantet ftohen të dergojnëonline dokumentacionin e specifikuar në thirrjen e shpallur. Shpallja gjithashtu bëhet edhe në rrjetet sociale të universitetit. Vlerësimi i kandidatit kalon në 2 faza:<br>✓ Vlerësimi paraprak i dosjes<br>✓ Intervista<br><br>Aplikantët njoftohen nga ZMBNJ përmes mail-it /telefonit.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.1.6 Manuali i Menaxhimit te Burimeve Njerezore.pdf<br><br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf, Neni 55<br><br>A.1.8 Formati i Dosjes personale të stafit.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në IAL, është 1 personel ndihmës akademik i angazhuar pranë departamentit të Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike. Nëbashkepunim me personelin akademik ata percaktojnë nevojat e laboratorit në lidhje me programin e studimit.<br><br>**Evidenca**:<br><br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 1.1, 1.2, 2) |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të | GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme dosje të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm, nga ku konsaton se ZMBNJ ka dosjet me dokumentat përkatëse për të gjithë personelin, ku për çdo pedagog të programit disponon të dhënat e kualifikimeve të tij/ të saj, kontratat e punës, dokumenta që lidhen me vjetërsinë në punë, të dhëna për zhvillimin e vijueshëm profesional. Të dhënat azhornohen çdo vit akademik. |

| | |
|---|---|
| përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | **Evidenca:**<br>Vizita ne IAL |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Univeristeti Barleti ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në rang universiteti. Janë marrëveshje me universitete kombëtare/ndërkombëtare, institucione ose kompani. Këto marrëveshje i vijnë në ndihmë studentëve për zhvillimin e praktikave profesionale.<br><br>**Evidenca:**<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 5)<br>A.1.7 Paketa e Praktikës.pdf<br>A.3.7 Marreveshje bashkepunimi.pdf<br>A.3.10 Te dhena analitike bashkepunime praktika - v.a. 2022 - 2023.pdf |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Kurrikula e programit Master i Shkencave në "Informatikë e aplikuar", ka në përbërje Praktikën Profesionale. Univeristeti Barleti ***nuk ka një rregullore*** të miratuar për procesin e zhvillimit dhe vlerësimit të praktikave profesionale.<br><br>**Evidenca:**<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf, Neni 12<br>A.1.7 Paketa e Praktikës.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se në FSHAIK, programi Masteri Shkencave "Informatikë e aplikuar", personeli akademik efektiv dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush* |

| | |
|---|---|
| | *standardet në përputhje me fushën e programit, të mësimdhënies të programit të studimit.*<br>*Ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017*<br>*IAL-ja ka disa marrëveshje bashkëpunimi, në mbështetje të zhvillimit të praktikave profesionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ nga vizita në institucion konstaton se procesi mësimor zhvillohet në Kampusin nr.2. Univeristeti Barleti siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore për këtë program studii. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar.<br><br>**Evidenca:**<br>A.2.2 Planimetrite.pdf<br>A.3.19 Infrastruktura ne funksion te programit.pdf<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16)<br>Vizita GVJ në institucion |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së | Çdo klasë laboratori ku zhvillohen shumica e lëndëve të këtij programi studimi ka kompjuter dhe videoprojektor funksional dhe akses të përhershëm interneti. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. E gjithë godina mbulohet me rrjet wi-fi. |

| | |
|---|---|
| informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | **Evidenca:**<br>A.3.19 Infrastruktura ne funksion te programit.pdf<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16)<br>Vizita GVJ në institucion |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjetetë nevojshme për të trajtuar lëndë të shkencave kompjuterike, informatikës së aplikuar, duke siguruar një mësimdhënie të orientuar nga praktika.<br>**Evidenca:**<br>A.3.19 Infrastruktura ne funksion te programit.pdf<br>*Vizita ne IAL* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se BARLETI ka laborator të dedikuar për programin e studimit, i cili është i pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme për të trajtuar lëndë të shkencave kompjuterike.<br>**Evidenca:**<br>A.2.2 Planimetrite.pdf<br>A.3.19 Infrastruktura ne funksion te programit.pdf<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 16)<br>Vizita ne IAL |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se Institucioni ofron mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | IAL-ja vë në dispozicion të studentëve laboratoret për zhvillimin e praktikës profesionale, sipas nevojave dhe kërkesave të tyre. Gjithashtu bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me njësi jashtë IAL-së, si IAL të tjera, biznese etj, krijon mundësi për zhvillimin e praktikave [A.3.7 Marreveshje bashkepunimi.pdf].<br><br>**Evidenca:**<br>A.3.19 Infrastruktura ne funksion te programit.pdf<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 5)<br>A.3.7 Marreveshje bashkepunimi.pdf | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa ka mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies. Në dispozicion të studentëve janë auditorë dhe laboratorë modern në përmbushje të kërkesave të programit të studimit.*<br>*UniBA ka laborator të dedikuar për programin e studimit, i cili është i pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme për të trajtuar lëndë të shkencave kompjuterike. Marrëveshjet e bashkëpunimit me njësi jashtë IAL-së, si universitete, kompani, biznese etj, krijojnë mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJkonstaton se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura e cila ofrohet në format elektronik ose të |

| | |
|---|---|
| studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | printuar, mund të përdoren nga studentët për të marrë njohuritë në kurset e programit që ato ndjekin. Materialet në formë elektronike gjenden në klasat virtuale të krijuar në platformën googleclassroom. Gjithashtu UniBa disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar. Referuar syllabus-eve të paraqitura si evidenca, vërehet që kurset kanë literaturë në përputhje me përmbajtjen e kursit, e cila ofrohet ne shqip.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.3.13 Syllabuse.pdf<br><br>A.3.15 Të dhëna biblioteka për DSHAK.pdf<br><br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 17) |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | GVJ konstaton se çdo fillim viti akademik, përgjegjësi i njësisë bazë dhe koordinatori i programit të studimit në bashkëpunim me pedagogët e lëndës sugjerojnë titujt që duhet ti shtohen bibliotekës. Referuar syllabus-eve të paraqitura si evidenca, vërehet që kurset kanë literaturë në përputhje me përmbajtjen e kursit, e cila ofrohet në shqip, ***por literatura duhet azhornuar drejt 5 viteve te fundit.***<br><br>***GVJ rekomandon, azhornimin e literaturës së sugjeruar në syllabuse, pasi për kurse specifike, i përket viteve 2006-2010.***<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.3.13 Syllabuse.pdf<br><br>A.3.15 Të dhëna biblioteka për DSHAK.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Tek Univeristeti Barleti ofrohet nje biblioteke bashkëkohore, e cila i krijon mundësi studentëve te aksesojnë fizikisht dhe online materialet dhe tutorialet e nevojshme. Literaturat në bibliotekë shtohen cdo vit bazuar në kërksat e stafit akademik.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.3.15 Të dhëna biblioteka për DSHAK.pdf<br><br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 17) |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Bazuar në vizitën në IAL, u verifikua që Univeristeti Barleti ofron një bibliotekë fizike dhe online. Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe revista shkencore. Biblioteka ofron rreth 4200 tituj librash fizik, ku një përqindje relativisht të vogël zënë botimet shqip në mbështetje të programit të studimit.<br><br>**Evidenca:**<br>A.3.15 Të dhëna biblioteka për DSHAK.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Univeristeti Barleti, ofron një bibliotekë fizike dhe online. Biblioteka online ku mund të aksesojëBARLETI janë:<br>✓ Biblioteka elektronike ECONBIZ<br>✓ Biblioteka elektronike JSTOR<br>✓ Biblioteka elektronike SEARCH4LIFE<br>Këto hapësira ofrojnë materiale te aksesueshme, pa pagesë për studentët.<br>**Evidenca:**<br>A.3.15 Të dhëna biblioteka për DSHAK.pdf<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 17) |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Univeristeti Barleti, GVJ konstaton se në bibliotekë ka PC, me software-t e nevojshmëm, të lidhur në internet për të mundësuar një përdorim sa më eficent të burimeve që biblioteka ka apo ofron.<br>*Vizita ne IAL* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në | Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare zyrtare 8.00-19:45, dhe jo vetëm, ajo ofron shërbimin edhe në fundjavë. Këto orare janënë përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, në përgjigje edhe të nevojave të studentëve.Gjithashtu në UniBaofrohet platforma dixhitale e menaxhimit të librit, |

| | |
|---|---|
| përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | përmes së cilës studentët mund të aksesojnë literaturën e dëshiruar.<br><br>**Evidenca:**<br>https://umb.edu.al/biblioteka.html<br>Vizita ne IAL |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit të studimit Masteri shkencave në "Informatikë e aplikuar" me profile, çdo fillim viti akademik zhvillojnë procedurën për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit onlinepërmes një kërkese të departamentit bazuar në kërkesat e stafit. Në UniBa është krijuar edhe klubi 'BooksandTech'.<br><br>**Evidenca:**<br>A.3.15 Të dhëna biblioteka për DSHAK.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura e cila ofrohet në format elektronik ose të printuar, mund të përdoren nga studentët për të marrë njohuritë në kurset e programit që ato ndjekin. Materialet në formë elektronike gjenden në klasat virtuale të krijuara në platformën googleclassroom. UnivBARLETI disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar fizikisht ose online.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Univeristeti Barleti disponon një sistem të menaxhimit të të dhënave, siç është Portali Studentor, platforma GoogleClassroom, ku administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët. Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet perkatëse për tu log-uar në sistem, ku marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me arritjet e tyre akademike.UniBapo punon për implementimin e një sistemi të ri për menaxhimin e të dhënave, SISClastter.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.1.34 Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf<br><br>https://studentportal.umb.edu.al/ |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Sistemi i brendshëm i menaxhimit, administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit PAE/PAK, personelit ndihmës akademik, dhe zyrave përkatëse, siç është psh. Sekretaria, të angazhuar në realizimin e programit.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.1.34 Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf<br><br>https://www.umb.edu.al/<br><br>https://studentportal.umb.edu.al/ |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë | Përmes këtij sistemi ofrohet i gjithë dokumentacioni referuar statusit, pozicionit, interesit dhe qëllimit të kërkesës. |

| | |
|---|---|
| personelin dhe studentët e programit të studimit. | Stafi akademik, administrativ dhe studentët disponojnë email-et zyrtare të IAL-së. Komunikimi me publikun realizohet përmes faqes zyrtare web, mediave sociale etj.<br><br>A.1.34 Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | UniBa ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv, siç është Portali Studentor, platforma GoogleClassroom, ku administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët. Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet perkatëse për tu log-uar në sistem, ku marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me arritjet e tyre akademike.UniBa po punon për implementimin e një sistemi të ri për menaxhimin e të dhënave, SISClastter. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Sistemi i brendshëm i menaxhimit, monitoron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit PAE/PAK, personelit ndihmësakademik, dhe zyrave përkatëse, siç është psh. Sekretaria, burimet njerëzore etj. të angazhuar në realizimin e programit.<br><br>A.1.34 Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Informacionet që lidhen me programin e studimit Master i Shkencave "Informatikë e aplikuar" me profile, personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, gjuha shqipe dhe gjuha angleze.<br><br>**Evidenca:**<br><br>https://www.umb.edu.al/<br><br>https://fshaik.umb.edu.al/departamenti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-kompjuterike.html<br><br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf |
| **Konkluzione** | *UniBa disponon një sistem të menaxhimit të të dhënave studentore, 'Portali Studentor', nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me stafin dhe studentët. E gjithë procedura akademike realizohet përmes këtij sistemi. Sistemi i menaxhimit siguron akses për të gjithë personelin PAE/PAK dhe* |

| | |
|---|---|
| | *studentët e programit të studimit. Çdo zyrë akademike dhe administrative ka kredencialet e saj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Universiteti Barleti, GVJ konstaton se në fillim të çdo viti akademik, depoziton raporte pranë fakulteteve të njësive bazë dhe njësive administrative të tjera të universitetit për të mbledhur informacion mbi nevojat e tyre specifike. Në fillim të cdo viti akademik hartohet buxheti, i cili pasqyron shpenzimet bazuar në kërkesat e departamenteve dhe të ardhurat e IAL-së duke mbështetur një cikël të plotë studimi.UniBamban një fond rezervë në mbështetje të mbarëvajtjes së programit të studimit.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.30 Raporti Vjetor UniBa 2022-2023.pdf (pika 7.2) |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | GVJ konstaton se Universiteti Barleti fondet parësore i ka nga tarifat e studentëve, fondet e tjera përfshijnë konsulenca dhe shërbime, shërbime trajnuese, projekte dhe fonde të tjera kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare. Shpenzimet janë të ndara sipas:<br>✓ 21% shpenzime paga PAE/PAK, lektorë të ftuar;<br>✓ 37% shpenzimeoperacionale (didaktike dhe administrative;)<br>✓ 40% shpenzime promocionale, laboratore dhe pajisje<br>✓ 2% shpenzime perkordinator programi;<br><br>**Evidenca:**<br>Prot. 99 (Dt. 25.01.2024) ASCAL - Percillet dokumentacion shtese_Msc. Informatike e Aplikuar.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | GVJ konstaton se pasqyrat financiare auditohen nga nje kompani e huaj auditimi, "GrantThornton". Cdo vit raporti i pasqyrave financiare i nënshtrohet kontrollit sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare tëkontabilizimit. Institucioni kryen auditime të përvitshme,vlerëson dhe dokumenton gjëndjen e financimit dheefektivitetin financiar të tij. Të ardhurat për këtë program studimi bazohen në:<br>✓ 92% nga tarifat e studentëve;<br>✓ 2% konsulenca dhe shërbime;<br>✓ 4% shërbime trajnuese;<br>✓ 2% donacione;<br><br>**Evidenca:**<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf (Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 18) |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi | UniBa në fillim të çdo viti harton buxhetin vjetor dhe një parashikim të vetë institucionit dhe programit të studimit, që të kuptojë dhe planifikojë nevojat. Në UniBa zbatohet strategjia e diversifikimit të burimeve të të ardhurave. |

| | |
|---|---|
| realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | **Evidenca:**<br>Prot. 99 (Dt. 25.01.2024) ASCAL - Percillet dokumentacion shtese_Msc. Informatike e Aplikuar.pdf<br>A.1.30 Raporti Vjetor UniBa 2022-2023.pdf *(pika 7.2)*<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf *(Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 18)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | UniBa ka krijuar një portofol që shkon përtej aktivitetit akademik, ku përfshihen sherbime, projekte, grante, trajnime, konsulenca, donacione, për të rritur të ardhurat dhe ulur riskun e rënies së tyre. Në këtë mënyrë IAL-ja garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit "Informatikë e Aplikuar" dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtij programi.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.30 Raporti Vjetor UniBa 2022-2023.pdf *(pika 7.2)* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa ka qëndrueshmëri të të ardhurave. Çdo fillim viti hartohen pasqyrat financiare, ku përfshihen kërkesat dhe nevojat e njësisë bazë dhe programit të studimit.*<br>*Të ardhurat për këtë program studimi bazohen në:*<br>✓ *92% nga tarifat e studentëve*<br>✓ *8% konsulenca dhe shërbime, shërbime trajnuese, donacione* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | GVJ konstatoi se Universiteti Barleti, ndjek studentët nga hyrja në dalje, përmes një strukture te organizuar duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura. Njësitë kryesore që merren me zbatimin e këtyre procedurave janë:<br>✓ Zv. Rektori për çështjet studentore dhe komunitetin;<br>✓ Zyra e rekrutimit dhe regjistrimit;<br>✓ Dekani i studentëve;<br>✓ Zyra e Alumnit dhe Karrierës;<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.1 Statuti i Universitetit Barleti.pdf<br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf<br>A.1.2 Organigrama e UniBa.pdf |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstatoi se programi i studimit Master i shkencave 'Informatikë e Aplikuar' me profile mund të ndiqet nga çdo shtetas shqiptar, etnitë jashtë kufijve shtetërore si dhe cdo shtetas i huaj, në bazë të legjislacionit në fuqi. UniBa krijon mundësi komunikimi me ambjentin e jashtëm nëpërmjet web-it zyrtar, ditëve të informimit, broshurave etj.<br>**Evidenca:**<br>A.1.1 StatutiiUniversitetit Barleti.pdf, Kreu 6, Neni 55<br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf,Kreu 9<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf, Neni 24 |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | GVJkonstaton se çdo vit akademik, referuar urdhërit të Ministrisësë Arsimit dhe Sportit, për regjistrimet dhe transferimet, publikon në web-in dhe rrjetet sociale të UniBainformacion lidhur me programet e studimit dhe kriteret përkatëse [*Vendim Senati Nr. 4, dt. 9.02.2022*]. Propozimi bëhet nga departamenti përgjegjës për programin e studimit, miratim nga fakulteti përkatës dhe vendimi merret nga senati akademik, për kriteret e pranimit dhe kuotat e kandidatëve.<br><br>**Evidenca:**<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf, Neni 24<br>Prot. 99 (Dt. 25.01.2024) ASCAL – Percillet dokumentacion shtese_Msc. Informatike e Aplikuar.pdf |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, vlerësimet gjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të aksesueshme përmes faqes web dhe rrjeteve sociale që UniBa menaxhon. Gjithashtu në UniBa ndodhet zyra e rekrutimit dhe regjistrimit, që ndihmon të interesuarit. Në këtë program nuk ka student të transferuar.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.1 Statuti i Universitetit Barleti.pdf, Neni 55<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf, Neni 24<br>Prot. 99 (Dt. 25.01.2024) ASCAL – Percillet dokumentacion shtese_Msc. Informatike e Aplikuar.pdf<br>Ueb: https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-informatike-e-aplikuar.html |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të | GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe evidencat se përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Këto kritere bëhen publike në faqen web të Universitetit Barleti. UniBa komunikon me ambjentin e jashtëm nëpërmjet web-it zyrtar, ditëve të |

| | |
|---|---|
| veçanta të programit të studimit. | informimit, broshurave etj, ku pasqyron kriteret në lidhje me pranimin e studentëve në këtë program studimi.<br>**Evidenca:**<br>Diplomë Master Shkencor: Informatikë e Aplikuar - Universiteti "Barleti" (umb.edu.al) |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe evidencat se përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, në përputhshmëri me Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe kandidatëve nga shtete të tjera.<br>Sa i përket evidencave të paraqitura nga GVB, rezulton që për këtë program studimi nuk ka kritere të veçanta, mjafton që kandidatët kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i liçensuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit. [Diplomë Master Shkencor: Informatikë e Aplikuar - Universiteti "Barleti" (umb.edu.al)]<br>***GVJ rekomandon:***<br>***Të përcaktohen kriteret për ndarjen e profileve dhe mënyra e përzgjedhjes nga ana e studentëve.***<br>**Evidenca:**<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf, Neni 24-25 |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Në përputhshmëri me Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera, IAL-ja publikon përpara çdo viti akademik kriteret. Kriteret bëhen publike përmes faqes web, rrjeteve sociale, fletëpalosjeve etj.<br>**Evidenca:**<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf, Neni 24-25 |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave | GVJ konstatoi nga vizita në IAL se UniBa ka përcaktuar politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë bazuar në |

| | |
|---|---|
| për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS. Gjithashtu me mbështetjen e administratorit, sipas një procedure të mirëpërcaktuar me ligj, IAL-ja organizon komisione ad-hoc për të shqyrtuar dhe ofruar tarifa të reduktuara për studentët në nevojë.<br>**Evidenca:**<br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf, *Neni 84* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se Universiteti Barleti harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Masteri Shkencave "Informatike e Aplikuar" me profile. Universiteti përdor faqen zyrtare të uebit, rrjetet sociale si mjet komunikimi gjithëpërfshirës. Universiteti Barleti ofron mundësinë e regjitrimit në këtë program, studentëve shqiptarë, të huaj etj. Universiteti ofron bursa për studentët me arritje të larta dhe bursa sociale.*<br>***GVJ rekomandon:***<br>*Të përcaktohen kriteret për ndarjen e profileve dhe mënyra e përzgjedhjes nga ana e studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe | GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe RVB e dorëzuar në sistem se UniBaka një sistem të organizuar për menaxhimin e informacionit. IAL vë në dispozicion një informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Informacioni për mënyrën e vlerësimit, u dërgohet studentëve përmes mail-it, ose përmes sekretarisë mësimore. Koordinatori |

| | |
|---|---|
| kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | i programit të studimit ndjek studentët dhe koordinon procesin akademik brenda dhe jashtë.<br>**Evidenca:**<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf<br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf, Neni 25<br>A.3.9 Vendim Nr. 32 dt. 14.10.2022 Përemërim e koordinatorittë DSHAK.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Në programin e studimit Masteri shkencave "Informatikë e aplikuar" me profile nuk ka patur raste transferimi të studentëve. Megjithatë procedura është e paraqitur qartë në rregulloren e transferimeve, manualin e regjistrimeve dhe transferimeve dhe rregulloren e programit të studimit.<br>**Evidenca:**<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf<br>A.1.22 Rregullore e Brendshme per Transferimet_Update ne 2023.pdf<br>A.1.20 Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferimi studenteve DHJETOR 2022.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Bazuar ne dokumentacionin e ofruar nga IAL-ja dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit. Java e parë të mësimit shërben si prezantimi i programit të lëndës dhe vlerësimit përkatës.<br>**Evidenca:**<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf<br>A.3.13 Syllabuse.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e | GVJ konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e diplomimit të studentëve në programin e studimit master i shkencave "Informatikë e Aplikuar", në vitin e dytë të |

| | |
|---|---|
| punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | studimeve. UniBa ka hartuar një dokument 'Paketa e provës finale', ku tregohet plani i detajuar i procesit të diplomimit.<br><br>**Evidenca:**<br>A.2.1 Rregullore FSHAIK.pdf, Neni 16<br>A.3.11 Paketa e proves finale.pdf |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | UniBa përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale që ai menaxhon, ambientet e IAL-së, fletëpalosje dhe broshura, të cilat japin informacion rreth përshkrimit të programit të studimit, objektivat, kriteret, mundësitë e punësimit, kurrikulën etj. Gjithashtu në Univ. BARLETI, organizohet Java e Orientimit, e cila shërben për njohjen e studentëve me ambientet dhe stafin.<br>**Evidenca:**<br>A.1.33.9 Plani i punes Dekani i studenteve 2023-2024.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale që ai menaxhon, ambientet e IAL-së, fletëpalosje dhe broshura. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit dhe procesin e diplomimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe | Studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe fletëpalosje/ udhëzues për lëndët/modulet, kurrikulën dhe |

| | |
|---|---|
| kohëzgjatjen e programit të studimit. | veprimtaritë formuese. Ky informacion gjendet në rregulloren e programit të studimit.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.33.5 ManualiiKlubeveStudentore 2022.pdf<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf<br>A.3.13 Syllabuse.pdf<br>A.3.3 Plani Mesimor MSc. Informatike e Aplikuar me 3 profile.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | IAL-ja organizon aktivitete për studentët që të informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, kurset, semestrat, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ky informacion ofrohet përmes fletëpalosjeve/ udhëzuesve, njoftimeve etj.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.33.5 Manuali i Klubeve Studentore 2022.pdf<br>A.3.2 Rregullore MSc. Informatike e Aplikuar me profile.pdf<br>A.3.13 Syllabuse.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | UniBa ka struktura të mirëpërcaktuara në mbështetje të studentëve. Në strukturën e Universiteti Barleti, ka njëstrukturë përgjegjëse për orientimin dhe informimin e studentëve, siç janë Bordet e Karrierës ku bëjnë pjesë profesionistë dhe ekspertë të fushës. Dekani i studentëve dhe zyra e Alumnit dhe Karrierës synojnë mbështetjen e universitetit dhe studentëve në tregun e punësimit.UniBa ka bashkëpunime të shumta në ndihmë të studentëve të degës Master i Shkencave "Informatikë e Aplikuar". |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën | Studentët e degës Master i Shkencave "Informatikë e Aplikuar"me porofile njihen me orarin që në fillim të semestrit. Nëse do ketë ndryshime, studentët njoftohen përmes sekretarisë mësimore ose me email zyrtar. Koordinatori i Departamentit, Dekani i studentëve dhe sekretaria mësimore mbajnë kontakte të afërta dhe të shpeshta me studentët. Në UniBa zhvillohen Java e orientimit, ku studentët njihen me ambientet dhe personelin |

| | |
|---|---|
| dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | përgjegjës për menaxhimin e tyre. Ky informacion mund të gjendet edhe në faqen webhttps://www.umb.edu.al/ |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Informacioni në lidhje me programin e studimit paraqitet nëfaqen web të Universitetit Barleti, e cila është lehtësisht e arritshëm nga studentët kudo ata ndodhen. Studentët marrin informacion rreth performancës dhe arritjeve të tyre akademike përmes portalit studentor në çdo moment.<br>**Evidenca:**<br>https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-informatike-e-aplikuar.html<br>A.1.34 Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa ka struktura të mirë përcaktuara në mbështetje të studentëve. Në UniBa zhvillohen ditët e orientimit, ku studentët njihen me ambientet dhe personelin përgjegjës për menaxhimin e tyre. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | GVJ konstatoi se UniBa mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar, në programet e studimit që ofron. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet nëprogram dhe largimet. Në këtë program studimi statistikat janë si më poshtë:<br>- Viti 2021-2022, 6 studentë të regjistruar, 1 student i larguar;<br>- Viti 2022-2023, 10 studentë të regjistruar; |

| | |
|---|---|
| | - Viti 2023-2024, 13 studentë të regjistruar;<br>Ky program nuk ka akoma student të diplomuar. Në sekretari nuk ka regjistër notash pasi IAL-ja nuk është pajisur akoma nga QSHA-ja.<br>**Evidenca:**<br>Prot. 99 (Dt. 25.01.2024) ASCAL – Percillet dokumentacion shtese_Msc. Informatike e Aplikuar.pdf].<br>Raporti i Vleresimit te Brendshem - MSc. IA.pdf *(Aneks, Tabelat Përmbledhëse, Tabela 21,23)* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Studentët informohen në fillim të çdo viti për mënyrën organizimit të kurseve, kreditet, vlerësimin përmes syllabusit të kursit. Informacioni ruhet në format elektronik dhe hard-copy, në sekretarinë mësimore në regjistrin themeltar. IAL-ja disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit<br>- Viti 2021-2022, 6 studentë të regjistruar, 1 student i larguar<br>Në këtë program nuk ka akoma student të diplomuar. |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Informacioni statistikor në lidhje me programin e studimit ruhet në sekretarinë mësimore. Studentët aksesojnë informacionin e vlerësimit, notave, provimeve përmes një sistemi të brendshëm që është 'Portali studentor'.<br>**Evidenca:**<br>https://studentportal.umb.edu.al/<br>A.1.34 Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të | GVJ konstatoi qëdepartamenti përmes një komisioni ad-hoc zhvillon kontrolle periodike ku vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe programet e studimit. Këto të dhëna |

| | |
|---|---|
| brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | ruhen në sekretarinë mësimore. Në funksion të studentëve është portali studentor.<br><br>**Evidenca:**<br>https://studentportal.umb.edu.al/ |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë harton raporte analitike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, përqindjen e cilësisë së punësimit të tyre. Ky informacion paraqitet ne raportin vjetor të IAL-ës. Në raport përfshihen edhe rekomandimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve. Në këtë program studimi nuk ka akoma student të diplomuar.<br><br>**Evidenca:**<br>A.3.4.1 Analiza dhe raporti vjetori DSHAK 2022.pdf<br>A.3.4.2 Analiza dhe raporti vjetori DSHAK 2023.pdf<br>A.3.24.1 Raporti i vleresimit te studenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. I.pdf<br>A.3.24.2 Raporti i vleresimit te studenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. II.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master i Shkencave "Informatikë e Aplikuar"me profile. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet në program dhe largimet. Në sekretari nuk ka regjistër notash pasi IAL-ja nuk është pajisur akoma nga QSHA-ja. Në këtë program studimi nuk ka akoma student të diplomuar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5** |
|---|

<table>
<tr><th colspan="2">Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</td><td>UniBa parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 dhe statutin e universitetit, studentët janë të përfaqësuar në organe vendimmarrëse, si:<br>1. Senati akademik;<br>2. Këshillin e etikës dhe shanseve të barabarta;<br>3. Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;<br>4. Dekanati i fakultetit;<br>5. Qeveria studentore;<br>6. Mbledhje e hapur departamenti;<br>Studenti ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përfaqësinë studentore.<br><br>Evidenca:<br>A.1.1 Statuti i Universitetit Barleti.pdf<br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf<br>A.1.33.1 Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura organizative të tyre.pdf<br>A.1.33.2 Rregullore e zyrave studentore dhe keshillimit te karrieres.pdf<br>A.1.33.3 Rregullore Qeveria Studentore.pdf</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</td><td>Univ. Barleti, garanton përfshirjen e studentëve në vendimarrje, i cili në bashkëpunim me organet drejtuese ushtron veprimtarinë e tij. Studentët përfshihen përmes opinionit të tyre në hartimin e raportit vjetor. Gjithashtu studentët përfshihen në vlerësimin e procesit akademik.<br><br>Evidenca:<br>A.1.33.1 Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura organizative të tyre.pdf</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | A.1.11 Formular i vleresimi i studenteve per lenden.pdf<br><br>A.1.33.3 Rregullore Qeveria Studentore.pdf<br><br>A.1.33.2 Rregullore e zyrave studentore dhe keshillimit te karrieres.pdf |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | GVJ konstatoi se njësitë përgjegjëse, dekanati, koordinatori, në fund të çdo semestri mbledhin të dhëna dhe informacion, me qëllim të diskutojnë performancën, kushtet laboratorike, nevojat dhe pritshmëritë, rishikimi i sugjerimeve për syllabuset dhe kurrikulën. Njësia e zhvillimit të kurrikulës dhe cilësisë kryen anketime 2 javë para mbarimit të çdo semestri, për çdo kurs dhe pedagog. Gjithashtu zhvillohen takime me Fokus-Grupet, për diskutime dhe informacione.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.1.11 Formular i vleresimit i studenteve per lenden.pdf |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Studentët Master i Shkencave "Informatikë e Aplikuar", shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e lektorëve në formë anonime. Rezultatet analizohen dhe menaxhohen nga Njësia e zhvillimit tëkurrikulës dhe cilësisë. UniBa jep informacionin e plotë mbi procedurën e vlerësimit, rregulloren e IAL-së, rregulloren e programit të studimit dhe syllabuse. Nëse studenti ka pakënaqësi, ai mund të bëjë një ankimim, të cilin ja drejton dekanit. Dekani shqyrton kërkesën, dhe vendos nëse do e pranojë ose jo.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf, Neni 88-90 |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se studentët jane të përfaqësuar në UniBa. Ata përfaqësohen në Senatin akademik, Këshillin e etikës dhe shanseve të barabarta, Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Dekanati i fakultetit, Qeveria studentore, Mbledhje e hapur departamenti. Sugjerimet e tyre merren në konsideratë nga koordinatori i programit të studimit dhe përgjegjësi i departamentit. UniBa ka rregulloren e programit të studimit, e cila jep informacionin e plotë mbi procedurën e vlerësimit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.6<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | UniBa në strukturën e tij ka njësi, me qëllim informimin dhe mbështetjen e studentëve, për procesin mësimor, praktikat profesionale, gjetjen e punës pas diplomimit etj. Këto njësi janë:<br>- Zyra e pranimit;<br>- Dekani i studentëve;<br>- Zyra e Alumnit dhe Karrierës;<br>- Koordinatori i departamentit.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.21 Rregullore per Funksionimin e Sekretarise Mesimore.pdf<br>A.1.23 Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.pdf<br>A.1.33.2 Rregullore e zyrave studentore dhe keshillimit te karrieres.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Institucioni ka ngritur një sistem për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Njësitë përgjegjëse për këshillim dhe ndjekje të studentëve janë:<br>- Strukturat përgjegjëse, si fakulteti, departamenti etj;<br>- Dekani i studentëve;<br>- Sekretaria mësimore; |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e | UniBa u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Dekani i studentëve dhe Zyra e alumnit dhe karrierës, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, |

<table>
<tr><td>karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</td><td colspan="4">zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Studentët aktualë të këtij programi studimi do të informohen dhe këshillohen përgjatë vitit akademik 23-24. Klubi i karrierës organizon aktivitete për zhvillimin e karrierës.<br><br>Evidenca:<br>A.1.23 Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.pdf<br>https://students.umb.edu.al/klubet-studentore.html</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</td><td colspan="4">Zyra e alumnit dhe karrierës ndjek studentët pas diplomimit. Kjo zyrë përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit master i shkencave "Informatikë e Aplikuar" me profile. Zyra e alumnit dhe karrierës realizon orientimin profesional, këshillimin individual ose në grup, gjithashtu bashkëpunon me klubin e karrierës dhe Alumni. Çdo vit kjo zyrë harton plane dhe raporte vjetore për gjurmimin e studentëve.<br>Për këtë program studimi nuk ka akoma studentë të diplomuar.<br>Evidenca:<br>A.1.23 Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.pdf, Neni 10-12.<br>Evidenca:<br>A.1.23 Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.pdf, Neni 10-12.</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ konstatoi se UniBa u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Njësia për këshillimin e karrierës, Zyra e Alumnit dhe Karrierës, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Kjo zyrë realizon orientimin profesional, këshillimin individual ose në grup, gjithashtu bashkëpunon me Studentët dhe Alumni.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, vërehet se në UniBa ka një njësi të qëndrueshme, Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë. Kjo njësi bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet dhe menaxhon procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike, bazuar në strategjinë e zhvillimit institucional. GVJ konstatoi se janë miratuar disa rregullore që i vijnë në ndihmë këtij qëllimi:<br>- Rregullorja e Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë;<br>- Rregullorja e njësisë së zhvillimit kurrikular dhe cilësisë;<br><br>IAL ka hartuar udhëzues për implementimin e metodave inovative.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.19 Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë.pdf<br>A.1.9 Rregullore e Njësise së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.pdf<br>A.1.13 Udhëzues për metodat e mësimdhënies.pdf<br>A.1.34 Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë | NJZHKC, zv.rektori për çështjet akademike, zyra e vlerësimit të performancës dhe njësitë kryesore dhe bazë bashkërendojnë |

| | |
|---|---|
| mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | punën, që të vlerësojnë aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Përmes pyetësorëve që zhvillohen në mënyrë periodike, mblidhen dhe analizohen të dhëna.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.10 Formular vleresimi te mesimdhenies kolege me kolege.pdf<br>A.1.11 Formular i vleresimi i studenteve per lenden.pdf<br>A.1.15 Format i Raportimit të Punës Semestrale.pdf<br>A.1.32 Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve.pdf<br>A.1.17 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | UniBa ofron metoda për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësori, dhe përmes Fokus Grupeve. Studentët në UniBa kanë hapësirë dhe mundësi të ankimojnë pakënaqësitë e tyre.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.11 Formular i vleresimi i studenteve per lenden.pdf<br>A.1.32 Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve.pdf<br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf<br>A.3.24.1 Raporti i vleresimit te studenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. I.pdf<br>A.3.24.2 Raporti i vleresimit te studenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. II.pdf |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | NjZhKC bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon. Gjithashtu rezultatet i dërgohen njësive drejtuese, duke ofruar transparencë në menaxhimin e tyre.<br><br>**Evidenca:** |

| | |
|---|---|
| | A.1.29 Raport per Vleresimin e Cilesine ne UniBa.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Univ. BARLETI nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra nga pyetësorët, afishon rezultatet në raportin vjetor, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJZHKC dërgon tek rektori raportin, i cili diskutohet dhe shpërndahet në instancat përkatëse. Dekani dhe përgjegjësi i departamentit, trajtojnë rastet sipas specifikave, duke përmirësuar metodat e mësimdhënies.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.17 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.pdf<br>A.1.37 Promovim i shembujve te praktikavete mira.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa ofron mjete për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësori.NJZHKC bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi VI.2<br><br>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me | UniBa në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 dhe statutin e universitetit, ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Në këtë IAL, ekziston NJZHKC, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. GVJ konstatoi se ka disa njësi që i vijnë në ndihmë këtij qëllimi: |

| | |
|---|---|
| aktet rregullatore institucionale. | - Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë;<br>- Njësisë së zhvillimit kurrikular dhe cilësisë;<br><br>Këto njësi kanë bashkëpunuar për shkrimin dhe miratimin e rregulloreve për mbarëvajtjen e proceseve akademike.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.1.19 Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.pdf<br><br>A.1.9 Rregullore e Njësise së Zhvillimit tëKurrikulavedhe Cilësisë.pdf<br><br>A.1.1 Statuti i Universitetit Barleti.pdf,*Neni 10, 28*<br><br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf, *Neni 14,15*<br><br>A.1.17 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.pdf, Neni 15 |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetësorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon. Kjo njësi ka disa detyra, si:<br><br>- Përmirësimin i cilësisë së mësimdhënies;<br>- Rishikimin e syllabuseve dhe kurrikulave;<br>- Pasurimi i bibliotekës;<br><br>Kjo njësi është e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm, në varësi të kërkesave të tregut. NJZHKC bashkëpunon me zyrën e Alumnit dhe Karrierës, zyrën e pranimeve, dekanin e studentëve, departamentin, fakultetin, ku krijon një urë lidhëse me studentët Alumni.<br><br>**Evidenca:**<br><br>A.1.4 Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030.pdf<br><br>A.1.23 Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentë vepranë UniBa.pdf<br><br>A.1.28 Plan Pune NJZHKC.pdf |

| | |
|---|---|
| | A.3.7 Marreveshje bashkepunimi.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | UniBa përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Ai përdor metodologji dhe teknika për vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. UniBanë kuadër të sigurimit të cilësisë realizon riakreditimin institucional dhe riakreditimin e programeve të studimit, bazuar në metodat e përcaktuara nga ASCAL. NJZHKC bashkëpunon me zyrën e Alumnit dhe Karrierës, zyrën e pranimeve, dekanin e studentëve, departamentin, fakultetin, ku krijon një urë lidhëse me studentët Alumni. Disa nga proceset e NJZHKC janë:<br>1. *Realizimi i proceseve të vlerësimit të mësimdhënies, nga studentët, lektorët etj.*<br>2. *Realizimi i proceseve të vlerësimit të kurrikulës, nga studentët, lektorët etj.*<br>3. *Paraqitja e rezultateve në raportin vjetor.*<br>**Evidenca**:<br>A.1.10 Formular vleresimitemesimdhenieskolege me kolege.pdf<br>A.1.11 Formular ivleresimittëstudenteve per lenden.pdf<br>A.1.32 Formularipërtransparencëtëvlerësimit studentëve.pdf<br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf<br>A.3.24.1 Raportiivleresimittestudenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. I.pdf<br>A.3.24.2 Raportiivleresimittestudenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. II.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të | UniBa, ofron mekanizma për matjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Stafi akademik raporton punën dhe angazhimin e tij gjatë semestrit sipas një formati të përcaktuar nga IAL-ja. Bazuar në manualin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe rregulloren e vlerësimit të performancës, IAL vlerëson dhe promovon stafin.<br>***GVJ rekomandon:***<br>***UniBa, duhet të përcaktojë qartazi vlerësimin e përkthyer në pikë, për ti ardhur në ndihmë renditjes së performancës dhe*** |

| | |
|---|---|
| mira në programin e studimit. | ***cilësisë së stafit. Kështu do jetë edhe më e qartë promovimi i stafit.***<br><br>**Evidenca**:<br>A.1.15 Format i Raportimit të Punës Semestrale.pdf<br>A.1.6 Manuali i Menaxhimit te Burimeve Njerezore.pdf<br>A.1.17 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.pdf<br>A.1.29 Raport per Vleresimin e Cilesine ne UniBa.pdf<br>A.1.30 Raporti Vjetor UniBa 2022-2023.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Ai përdor metodologji dhe teknika përmbledhjen e të dhënave në lidhje me vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, dhe NJZHKC, bashkëpunojnë me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike.*<br><br>***GVJ rekomandon:*** *UniBa, duhet të përcaktojë qartazi vlerësimin e përkthyer në pikë, për ti ardhur në ndihmë renditjes sëperformancës dhe cilësisë së stafit. Kështu do jetë edhe mëi qartë promovimi i stafit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara | UniBa përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë pedagogjike dhe akademike. Në fund të çdo viti akademik, NJZHKC përgatit një raport, të cilin e shpërndan në formë zyrtare. Bazuar në të dhënat e raportit |

| | |
|---|---|
| për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br><br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | nxirren rezultate dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies. Gjithashtu departamenti vlerëson në mënyrë periodike veprimtaritë mësimore dhe kërkimore-shkencore, rezultati cili paraqitet në raportet vjetore të njësisë bazë.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.29 Raport per Vleresimin e Cilesine ne UniBa.pdf<br>A.3.4.1 Analiza dhe raporti vjetori DSHAK 2022.pdf<br>A.3.4.2 Analiza dhe raporti vjetori DSHAK 2023.pdf<br>A.3.24.1 Raporti i vleresimit te studenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. I.pdf<br>A.3.24.2 Raporti i vleresimit te studenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. II.pdf |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Raportet e vlerësimit të cilësisë përfshijnë rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit dhe analizën krahasuese me rezultatet e një viti më parë. Bazuar në këto rezultate nxirren rekomandimet perkatëse. Këto rezultate i komunikohen njësive drejtuese.<br><br>NJZHKC harton raportin vjetor të përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, | UniBa në këtë program studimi përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Vlerësimi i stafit me kohë të plotë, realizohet si mëposhtë:<br>- Mësimdhënie 50%<br>- Realizimi i ngarkesës<br>- Vlerësimi nga studentët |

| | |
|---|---|
| vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | - Kërkim shkencor dhe projekte 10%<br>- Administrim dhe funksione të tjera 40%<br>- Kurse për stafin me kohë të pjesshme, vlerësimi bëhet si vijon:<br>- Lëndët e mbuluara nga pedagogu<br>- Realizimi i orëve<br>- Vlerësimi i studentëve<br>- Vlerësimi i departamentit<br>***GVJ rekomandon një unifikim të mënyrës së vlerësimit, peshës që ka secili zë.***<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.17 Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.pdfA.1.15 Format i Raportimit të Punës Semestrale.pdf<br>A.1.11 Formular i vleresimi i studenteve per lenden.pdf<br>A.1.10 Formular vleresimi te mesimdhenies kolege me kolege.pdf<br>A.1.32 Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve.pdf<br>A.3.25 Raport mbi monitorimin e mësimdhënies në distance nëpërmjet teknikave digjitale dhe internetit.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera | UniBA përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ. Stafi i ri, këshillohet, orientohet dhe njihet me praktikat më të mira që të kenë një përmirësim të vazhdueshëm. Një tjetër metodë vlerësuese në Univ.BARLETI janë edhe mbledhjet mujore në departament apo edhe sondazhet studentore. |

| | |
|---|---|
| që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë pedagogjike dhe akademike. Në fund të çdo viti akademik, NJZHKC përgatit një raport, të cilin e shpërndan në formë zyrtare njësitë drejtuese. Raportet e vlerësimit të cilësisë përfshijnë rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit dhe analizën krahasuese me rezultatet e një viti më parë. Bazuar në këto rezultate nxirren rekomandimet përkatëse.*<br><br>***GVJ rekomandon** një unifikim të mënyrës së vlerësimit, peshës që ka secili zë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Në UniBa, ka bashkëpunim ndërmjet fakulteteve dhe departamenteve, në ndihmë të ruajtjes së cilësisë së programit të studimit Masteri Shkencave "Informatikë e Aplikuar"me profile,. NJZHKC komunikon dhe bashkëpunon vazhdimisht me Fakuletin/ Departamentin që ofron këtë program studimi.<br><br>Rezultatet e përpunuara nga pyetësorët përfshihen në performancën akademike që drejtuesi i njësisë kryesore, përpilon në fund të çdo viti akademik. NJZHKC ka përgjegjësi në menaxhimin, hartimin, përcaktimin e kritereve, parimeve dhe standardeve për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, akreditimin e programeve dhe IAL-së. |

| | |
|---|---|
| | **Evidenca:**<br>A.1.3 Rregullore e universitetit Barleti.pdf<br>A.1.19 Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.pdf<br>A.1.9 Rregullore e Njësise së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.pdf<br>A.1.28 Plan Pune NJZHKC.pdf<br>A.1.27 Manualii Cilesise.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | GVJ vëren se gjatë mbledhjeve të senatit, rektoratit, dekanatit nëUniBa përcakton qartë detyrat dhe funksionet, përshkallëzimi i tyre nga njësia kryesore, tek njësia bazë e deri në nivel lektorësh. Një sërë detyrash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarjeve në orë leksionesh të hapura me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Një rol me rëndësi ka komisioni i sigurimit të cilësisë(KSSC), i cili shërben si urë lidhëse ndërmjet studentëve dhe njësive përkatëse. Në strukturën e KSSC ka një përfaqësues të studentëve. Përmes zyrës së Alumnit dhe Karrierës realizon kontakte të vazhdueshme me alumnin studentor mbi ecurinë e tregut të punës dhe mendimin për përmirësimin e programeve të studimit.<br>**Evidenca**:<br>A.1.4 Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030.pdf,<br>A.1.33.2 Rregullore e zyrave studentore dhe keshillimit te karrieres.pdf, Neni 10,11<br>A.1.33.8 Plani Strategjik Alumni dheKarriera 2020 - 2025.pdf<br>A.1.19 Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarde vetë Cilësisë.pdf<br>A.3.7 Marreveshje bashkepunimi.pdf |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të | UniBa operon me procedura të sigurimit të cilësisë që demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë anëtarët e saj. Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me KSSC. Të gjitha |

| | |
|---|---|
| personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | politikat për sigurimin e cilësisë së proceseve akademike hartohen nga organe kolegjiale si, Senati, Rektorati, Dekanati etj. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | UniBa vlerëson dhe favorizon përshkallëzimin e metodikës në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të IAL në këtë drejtim. UniBa është transparent lidhur me informacionin apo aktivitetin që duhet të realizohet lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo transparencë është parashikuar edhe në statutin e IAL-se.<br>**Evidenca:**<br>A.1.1 Statuti i Universitetit Barleti.pdf<br>A.1.5 Kodi i Etikës.pdf |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Në nivel institucional, UniBa ka disa marrëveshje bashkëpunimi. Kjo lejon që të ketë mobilitet të stafit dhe studentëve, si një element plus në shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet palëve. Gjithashtu në UniBa konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Masteri Shkencave "Informatikë e Aplikuar" me profile.<br>**Evidenca:**<br>A.3.7 Marreveshje bashkepunimi.pdf<br>A.3.23 Ngritja e Bordittë Karrierës.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa operon me proçedura të sigurimit të cilësisë që demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me KSSC. Të gjitha politikat për sigurimin e cilësisë së proceseve akademike hartohen nga organe kolegjiale si, Senati, Rektorati, Dekanati etj.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi VI.5<br><br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC, bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në proçesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon si dhe në faqen web të IAL-së:<br><br>**Evidenca:**<br>https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html<br>https://umb.edu.al/neës4901.html |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | UniBa, publikon rezultatet e vlerësimeve, ne raportin vjetor të përpunuar nga NJZHKC, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike. IAL-ja vepron mbi parimet e përcaktuara në rregulloren e UniBa dhe NJZHKC. Këto parime sigurojnë transparencë dhe respektojnë legjislacionin mbi të dhënat personale.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.29 Raport per Vleresimin e Cilesine ne UniBa.pdf<br>A.1.9 Rregullore e NjësisesëZhvillimittëKurrikulavedhe Cilësisë.pdf<br>https://umb.edu.al/dossier-uniba.html |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe | Rezultatet e vlerësimit adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Në fund të çdo viti, rezultatet e vlerësimithartohen në formën e Raportit Vjetor, ku nga analiza e këtyre të dhënave përcaktohen rekomandimet për |

| | |
|---|---|
| synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies. NJZHKC udhëzon njësitë bazë dhe kryesore në lidhje me pikat e dobëta dhe pikat e forta.<br><br>**Evidenca:**<br>A.1.29 Raport per Vleresimin e Cilesine ne UniBa.pdf<br>A.3.24.1 Raporti i vleresimit te studenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. I.pdf<br>A.3.24.2 Raporti i vleresimit te studenteve per v.a. 2022 - 2023 - Sem. II.pdf |
| | |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | UniBa ka një strukturë organizative të qëndrueshme dhe efektive e drejtuar ndaj përmirësimeve të vazhdueshme, bazuar në kërkesat institucionale, ligjore dhe standardet e cilësisë. Në lidhje me programin e studimit, janë marrë masa për rishikimin dhe përmirësimin e rregullores, kurrikulës, syllabuseve etj. Ndryshime rrënjësore për programin e studimit, mund të bëhen vetëm nga një akreditim në tjetrin. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | NJZHKC harton një plan periodik aktivitetesh, ku përfshihen takime, mbledhje, njoftime në lidhje me proceset e akreditimit, të cilat lidhen me cilësinëe programit që ata bëjnë pjesë.<br><br>**Evidenca:**<br>https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html<br>https://umb.edu.al/news4901.html |
| **Konkluzione** | *GVJ konstatoi se UniBa ka një strukturë të drejtuar ndaj përmirësimeve të vazhdueshme, bazuar në kërkesat institucionale, ligjore dhe standardet e cilësisë. UniBa publikon rezultatet e vlerësimeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Informatikë e Aplikuar" me profile "Inxhinieri softueri", "Rrjetet dhe siguria kibernetike" dhe "Përpunim të dhënash"</u>**

a. **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit ofron profile bashkëkohore dhe të kërkuara nga ekonomia e tregut;
2. Programi ka zhvilluar bashkëpunime efikase në kuadër të praktikave profesionale, duke siguruar që studentët të kenë përvojë praktike dhe kontakte me industrinë;
3. Universiteti ofron infrastrukturë moderne për stafin dhe studentët, përfshirë laboratorë të krijuar për të mbështetur kurrikulën dhe programin e studimit;
4. Universiteti disponon qendra kërkimore dhe inovative që mbështesin zhvillimin e projekteve kërkimore dhe inovative nga studentët dhe stafi akademik. Këto qendra ofrojnë mundësi për zhvillimin e aftësive praktike dhe krijuese dhe nxisin një kulturë të kërkimit dhe inovacionit brenda universitetit;

**Pika të dobëta**

1. Ngarkesa totale e stafit akademik PAE është e lartë; **(Standardi IV.1, Kriteri 2)**
2. Mungesa e literaturës hardcopy në gjuhën shqipe dhe anglisht (e 5 viteve të fundit) për fushën e Informatikës në bibliotekën e UniBa; **(Standardi IV.3, Kriteri 2)**
3. Nuk ka kritere përcaktuese/përzgjedhëse në lidhje me profilet e ofruara për këtë program studimi; **(Standardi V.1, Kriteri 6)**

**Rekomandime**

1. Programi ka një numër të reduktuar studentësh në "Informatikë e Aplikuar" në profilin "Inxhinieri softueri" dhe ende nuk ka aktiv dy profilet e tjera. IAL-ja duhet të ndërtojë mekanizma për nxitjen e studentëve që të zgjedhin këtë program studimi me të tre profilet

e tij, kjo do të mundësoj bërjen aktive edhe të dy profileve të tjera "Rrjetet dhe Siguria Kibernetike" dhe "Përpunim të Dhënash";
2. Të përcaktohen kriteret për ndarjen e profileve dhe mënyra e përzgjedhjes nga ana e studentëve;
3. Universiteti Barleti duhet të përcaktojë qartazi vlerësimin e përkthyer në pikë për të ndihmuar në renditjen e performancës dhe cilësisë së stafit. Kjo do të bëjë më të qartë procesin e promovimit të stafit;
4. Në planin mësimor përveç profileve në të cilat ka lëndë që diferencojnë ato, të shtohen edhe lëndët me zgjedhje;
5. Universiteti ka hapësira parkimi për stafin, por rekomandohet shtimi i hapësirave të parkimit për studentët;
6. Biblioteka e universitetit ka mungesë të literaturës specifike (hardcopy) për fushën e Shkencave Kompjuterike (SHK) në gjuhën shqipe, gjithashtu rekomandohet azhornimi i literaturës së sugjeruar, pasi për kurse specifike, i përket viteve 2006-2010;
7. Duke qenë se ngarkesa e stafit PAE të përfshirë në këtë program studimi është e lartë nga angazhimi i tyre edhe në programet e ciklit të parë, rekomandohet shtimi i Personelit Akademik me Kontratë;
8. Të nxitet pjesëmarrja e së studentëve në mobilitete;

**Evaluation's conclusions for the second cyclestudy program Master of Sciencesin "Applied Informatics" with profiles in "Software Engineering", "Networks and Cybersecurity", and "Data Processing"**

**a. Strengths and affirmations:**

1. The study program offers contemporary profiles and demanded by the market economy;
2. The program has developed efficient collaborations within professional practices, ensuring that students have practical experience and contacts with industry;
3. The University provides modern infrastructure for staff and students, including laboratories designed to support the curriculum and program of study;
4. The University has research and innovation centers that support the development of research and innovation projects by students and academic staff. These centers provide opportunities for the development of practical and creative skills, and foster a culture of research and innovation within the university;

**b. Weaknesses:**

1. The total workload of the effective academic staff is high; **(Standard IV.1, criterion 2)**

2. The lack of hardcopy literature in Albanian and English (of the last 5 years) for the field of Computer Science in the UniBa library; **(Standard IV.3, criterion 2)**
3. There are no defining/selection criteria regarding the profiles offered for this study program; **(Standardi V.1, Kriteri 6)**

**Recommendation**

1. The study program has a reduced number of students in "Applied Informatics" in the profile "Software engineering" and does not yet have the other two profiles active. The HEI should build mechanisms to encourage students to choose this study program with his three profiles, this will enable the activation of the other two profiles "Networks and Cyber Security" and "Data Processing";
2. To determine the criteria for profiles selection, by students;
3. Barleti University should clearly define the evaluation translated into points to help rank the performance and quality of the staff. This will make the staff promotion process clearer;
4. In the curriculum, in addition to the profiles, elective subjects should be added;
5. The university has parking spaces for staff, but it is recommended to add parking spaces for students;
6. The university library lacks specific literature (hard copy) for the field of Computer Science (SC) in the Albanian language. Also it must be updated within the last 5 years;
7. Since the workload of the PAE academic staff included in this study program is high, due to their engagement in the first cycle programs, it is recommended to increase the number of PAK academic staff;
8. To promote the participation of students in mobility;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |